

KOHA

për

Gratë



TOBI OTIJI

10 VJET



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Center for Gender Studies

KUOTA GJINORE MBETET MJETI I VETËM I PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË

Politika - terren i burrave

Edhe pse Kosova shpeshherë është marrë si shembull për përfaqësimin e femrave në jetën politike dhe institucionale, megjithatë politika vazhdon të konsiderohet “terren i burrave”. Ndërsa kuota gjinore mbetet mjeti më i rëndësishëm dhe i vetëm që femrave së paku i siguron një pjesëmarrje mbi 30 për qind në Institucionet e Kosovës

Fitim Gashi

Politika në Kosovë vazhdon të cilësohet si fushë e cila tradicionalisht u takon burrave. Ndërsa kuota gjinore mbetet mjeti më i rëndësishëm që femrave së paku i siguron një pjesëmarrje mbi 30 për qind në Institucionet e Kosovës. Edhe pse Kosova shpeshherë është marrë si shembull për përfaqësimin e femrave në jetën politike dhe institucionale, ky përfaqësim shihet vetëm si “matematikë”. Megjithëse partitë politike në vazhdimësi proklamojnë në barazinë gjinore dhe hapësirën që femrave u jepet në procese vendimmarrëse, megjithatë për poste të rëndësishme vazhdojnë të kandidojnë vetëm meshkuj. Shumica e subjekteve tanimë kanë nominuar kandidat burra për postin e kryeministrit në zgjedhjet nacionale që pritet të mbahen këtë vit. Megjithatë partitë premtojnë se në Listat për deputetë më shumë hapësirë do të kenë femrat.

Prej fundit të luftës misionet ndërkombëtare në Kosovë, e pas tyre edhe institucionet e vendit, kanë nxjerrë politika për hartimin e legjislacionit që promovon barazinë gjinore. Madje, Kosova shpesh merret shembull për krijimin e infrastrukturës ligjore për inkuadrimitin e gruas në jetën shoqërore dhe sidomos atë politike e institucionale. Megjithatë ky përfaqësim ende shihet si matematikë.

Zgjedhjet lokale sollën kryetaren e parë femër

Kosova nëntorin e vitit të kaluar zhvilloi zgjedhjet lokale, ku prej të gjitha listave zgjedhore të partive në 38 komunat e Kosovës, vetëm 8 gra ishin bartëse të listave respektive. Asnjëra prej tyre nuk ishte nga dy partitë më të mëdha, PDK-LDK. Vetëm Mimoza Kusari-Lila nga Aleanca Kosova e Re arriti të fitojë në Gjakovë duke u bërë kështu kryetarja e parë femër në një komunë të Kosovës. Por, ambienti garues për të nuk kishte qenë aq i favorshëm. Në një intervistë për “Koha Ditore” pas marrjes së detyrës Kusari-Lila pati thënë se gara e balotazhit kishte vënë në pah diferencat dhe qasjen diskriminuese ndaj femrës. Si e para në krye të një komune ajo ka premtuar se do ta konsiderojë pjesë të përgjegjësisë që t'i kërkojë partisë së vet por edhe të tjerave që në zgjedhjet e radhës të ketë femra të kualifikuara për postin e kryetares.

Zgjedhja e kryetares së parë femër në krye të komunës, është përshëndetur edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian, përkatësisht me Rezolutën e Parlamentit Evropian të datës 16 janar 2014. Por njëkohësisht PE ka kërkuar që të shtohet numri i grave në të gjitha nivelet administrative.

Përfaqësimi i femrës në drejtoritë komunale vazhdon të jetë i vogël. Sipas një hulumtimi të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore të vitit 2013, në 38 komuna janë mbi 320 drejtorë drejtorie, ndërsa prej tyre vetëm 20 janë gra. Që nga zgjedhjet e fundit lokale, zyrtaret më të larta në nivelin komunal janë tri gra, që mbajnë postet e kryesueseve të kuvendeve komunale - në Novobërdë, Pejë dhe Mamushë.

Në nivelin qendror, si e arritur e madhe në vazhdimësi është përmendur fakti se për herë të parë Kosova

udhëhiqet nga një presidente femër. Por në Qeverinë e Kosovës që ka 19 ministri është vetëm një zëvendëskryeministre dhe një ministre femër. Për më tepër, në nivelin qendror, numri i grave në pozita të larta (p.sh., shefe e departamentit) në zyrat e Qeverisë është shumë i ulët. Gratë zënë vetëm 12 për qind të pozitave të tilla ekzekutive.

Përfaqësimi në Kuvend

Në Kuvendin e Kosovës gratë përfaqësohen me 30 për qind. Nga gjithsej 120 deputetë, 40 janë gra. Por vetëm një grua është shefe e grupit parlamentar. Bëhet fjalë për Myzëjane Selmanin e AKR-së. Prej 13 komisioneve, vetëm tri udhëhiqen nga gratë (Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim).

Por që prej emërimit të një kandidate femër e deri tek realizimi i të drejtës së votës shumë raporte kanë vërejtur mangësi, sidomos tek çështja e votimit familjar. Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara të Këshilltarit Special mbi Çështjet Gjinore, “Votimi familjar krijon shumë mundësi t'i pengojë gratë nga aftësia për të votuar në mënyrë individuale dhe sekrete”. Çështje tjetër shqetësuese është edhe mos adresimi i votës së gruas. Një analizë e mëhershme për zgjedhjet, e realizuar nga Demokracia në Veprim, e dëshmon hendekun gjinor gjatë votimit. Përkundër numrit të madh të grave votuesve në Kosovë, përqindja e grave votuese që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit është më e ulët se ajo e burrave. Konsiderohet se çdo e treta grua del në votime.

Hulumtimi i QKSGJ-së po ashtu ka gjetur se grave nuk u jepet hapësirë në media. Prezenca e tyre zakonisht është e kushtëzuar nga përfshirja në ndonjë debat që ka të bëjë me “çështje madhore”.

“Dominimi i plotë i burrave politikanë në mediat kosovare bart te publiku mesazhin se ata janë më të thirrur për t'u marrë me politikë”.

Disa parti politike promovojnë fuqizimin e grave politikane dhe flasin për çështje gjinore në manifestimet gjatë fushatës zgjedhore. Kjo ndodh për shkak se shumica e partive politike ende nuk e kanë të inkuorporuar barazinë gjinore në plan-programet e tyre partiake.

Partitë politike janë të dominuara nga udhëheqësit burra të cilët kanë fjalën përfundimtare për përzgjedhjen e kandidatëve. Jo rrallë politikanet kosovare kanë raportuar në hulumtime të ndryshme se kolegët e tyre burra kanë tendencë për t'i përjashtuar ato nga takimet ku merren vendime të rëndësishme politike.

Disa parti politike në Kosovë e kanë të rregulluar në statutin e tyre përfaqësimin e gruas në politikë. Mekanizmi më i shpeshtë për gratë në partitë politike mbetet Forumi i Grave.

Partitë premtojnë tejkallimin e 30 për qindëshit në Lista Zgjedhore

Këtë vit mbahen zgjedhjet parlamentare në Kosovë dhe partitë politike tanimë kanë filluar t'i shqyrtojnë modalitetet e zgjedhjeve dhe figurave që do tu prezantojnë qytetarëve për votim. Megjithatë në poste të



mëdha, si ajo për kryeministër nuk pritet të nominohet ndonjë femër. Të paktën jo nga partitë e mëdha që tanimë veç kanë prezantuar kandidaturat për këtë post. Megjithatë subjektet premtojnë se në lista për deputetë do tu jepet më shumë hapësirë femrave.

Flora Brovina, që është deputete në Kuvendin e Kosovës nga Partia Demokratike ka thënë se zëri i femrës në partinë e saj është i “fuqishëm”.

“Në kuvendin e fundit zgjedhor të partisë, kemi vendosur që 30 për qind e grave të jenë të përfaqësuara edhe në Këshillin qendror. Dhe po ashtu çdo i tretë kandidat në listë do të jetë grua”, ka thënë Brovina. Sa i përket kryesisë së partisë, siç ka thënë Brovina, për herë të parë aty janë pesë gra, njëra prej tyre nënkryetare- Flora Çitaku.

“Ka edhe emra të rinj dhe kjo është një e arritur e madhe, por synojmë që të jemi një zë më i fuqishëm dhe të kemi një pjesëmarrje më të denjë duke u nisur edhe nga përqindja e anëtarëve gra në parti”, ka thënë ajo. Por partia e Brovinës, e cila udhëheqë me qeverinë ka vetëm një ministere femër. Deputetja Brovina thotë se nuk është përfaqësim real por pret që në ardhmen të marrin përgjegjësi më të mëdha.

Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës si partia më e madhe opozitare në vend thotë se do të tejkalojë 30 për qindshin e kërkuar me ligj. Kryetarja e forumit të gruas në LDK, Lirije Kajtazi ka potencuar se gratë që kanë fituar mandatin janë me votat e fituara e jo se këtë ua garanton ligji.

“Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm është deklaruar se pjesëmarrja e gruas në listat zgjedhore do të kalojë 30 për qindëshin e kërkuar. Kjo është edhe arsyeja pse gratë deputetë janë me votat e fituara e jo se këtë ua garanton ligji”, ka thënë deputetja e Kuvendit të Kosovës, Lirije Kajtazi.

“Ne presim ta kalojmë atë përqindje për arsye se në mandatin aktual deputetët e LDK-së janë me votat e fituara, jo nga përmbushja e kuotës”, ka nënvizuar Kajtazi.

“Vetëvendosje” pa kuota gjinore

Nga Lëvizja “Vetëvendosje” thonë se kanë krijuar hapësirë të barabartë për pjesëmarrjen e të gjithëve pa dallim. Nënkyetarja e këtij subjekti, Aida Dërguti ka nënvizuar se në vend të përfaqësimit formal të grave dhe vajzave, është siguruar pjesëmarrje përmbytëse.

“Aktualisht kemi rreth 30% të grave në vendimmarrje dhe vazhdimisht angazhohemi që ta rrisim pjesëmarrjen e tyre në të gjitha nivelet. Sa i përket vendimmarrjes në Lëvizjen Vetëvendosje është pesha e votës ajo që i përcakton vendimet dhe jo niveli i caktuar në hierarki apo gjinia. Statuti ynë e përcakton qartë se cilat vendime merren në Kryesi, në Këshill të Përgjithshëm, në Kryesi dhe Këshill të Qendrës apo edhe në rastet kur duhet të shkohet në referendum të brendshëm”, ka thënë Dërguti, duke shtuar më tej se vendimmarrja nuk është e koncentruar te lideri apo Kryesia dhe kjo e bën vendimmarrjen më të shëndoshë dhe demokratike. Lëvizja “Vetëvendosje” nuk ka vendosur kuota gjinore për shkak se sipas tyre nuk ekziston dallimi mes grave dhe burrave.

“Vlerësimi i njerëzve brenda Lëvizjes bëhet në bazë të disa kritereve të caktuara siç janë: dija, guximi, sakrifica dhe vetëmohimi. Bazuar në këto kritere edhe anëtarësia jonë iu beson individëve detyra të caktuara. Zgjedhjet lokale ishin dëshmia më e mirë e kësaj”, ka nënvizuar Dërguti. Edhe pse morën pjesë për herë të parë në zgjedhjet lokale, Dërguti thotë se arritën t'i kenë tri gra kandidate për kryetare dhe duke tejkalluar kështu në disa komuna kuotën e paraparë në listat e kandidatëve për këshilltarë komunal. Vetëm në Prishtinë 40 % e listës ka qenë e përbërë nga gratë dhe vajzat. Në asamblenë komunale grupi i “Vetëvendosjes” tani ka po këtë përbërje. Dërguti ka thënë se edhe në zgjedhjet nacionale gjinia femërore do të jetë e përfaqësuar më shumë se 30 për qind.

“Lista e Lëvizjes Vetëvendosje do të përbëhet nga kandidatët më të mirë që ka, pa e paragjykuar gjininë. Bazuar në potencialin që kemi aktualisht, jam e bindur se do të ketë më shumë se 30% të

grave brenda listës sonë”.

Edhe nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës thonë se për femrën ka hapësirë të mjaftueshme në parti dhe vendimmarrje. Nënkyetarja e Forumit të Gruas në AAK, Teuta Haxhiu që njëkohësisht është edhe deputete në Kuvendin e Kosovës ka deklaruar se do të ketë një përfshirje më të madhe të femrave në listën për deputet.

“AAK edhe me statut e ka të rregulluar 30 për qindëshin e garantuar me ligj, por hapësira nga kryetari nuk ka munguar asnjëherë që femra të jetë sa më e përfshirë në parti. Ndoshta ende nuk është arritur në nivelin e kënaqshëm, megjithatë për të ardhmen synojmë më shumë”, ka thënë Haxhiu, partia e së cilës tanimë ka nominuar Ramush Haradinajn për kryeministër. Sipas Haxhiut, në AAK cdo e treta femër është në kryesi.

“AAK është gjithmonë është në kërkim të kuadrove të reja femra dhe në legjislaturën e ardhshme ne synojmë ta rrisim numrin e tyre”, ka shtuar Haxhiu.

Përfaqësim jo real

Por ata që përcjellin proceset zgjedhore thonë se përfaqësimi i gjinisë femërore në zgjedhjet e fundit lokale ka qenë i mirë duke iu falënderuar vetëm kuotës gjinore. Rezarta Delibashzade nga “Instituti Demokraci për Zhvillim”-D4D si të arritur në përfaqësimin e gruas ka përmendur zgjedhjen e Mimoza Kusari-Lila në krye të një komune.

“Fatkëqesisht këtu edhe përfundon përfaqësimi i femrës si rezultat i zgjedhjes nga populli. Në zgjedhjet e fundit lokale kemi pasur shumë pak femra të përfaqësuara nëpër Komisionet komunale zgjedhore si dhe nëpër këshillat e vendvotimeve. Edhe bartësit e listës kanë qenë kryesisht meshkuj, dhe shumë pak femra kanë mundur të përfitojnë nga të qenit bartëse e listës votuese”, ka theksuar ajo. As në zgjedhjet parlamentare të këtij viti, ajo nuk pret ndonjë ndryshim.

“Kuota gjinore mbetet mjeti më i rëndësishëm i cili së paku siguron një pjesëmarrje mbi 30 % të gjinisë femërore në Kuvendin e ardhshëm të Kosovës. Nuk shihet se ka hapa tjerë të cilat do të ndikojnë në fuqizimin e gjinisë femërore”. Ajo thotë se praktikisht është e pamundur që të arrihet përparim në demokracinë e saj nëse Kosova nuk bëhet shoqëri më e barabartë, e cila fuqizon gratë dhe ushqen diversitetin.

“Përkundër se shoqëria kosovare është e përbërë në masën 50% nga gjinia femërore, ne kemi ende probleme me perceptimin e femrës si të barabartë përfshirë edhe në vendimmarrje. Paragjykimet mbeten ato të vjetrat në shumicën e rasteve ku femra shihet si diçka shumë e rëndësishme në familje por jo edhe e denjë për të qenë pjesëmarrëse në vendimmarrjet e rëndësishme politike”, thotë ajo.

Shoqëria civile vlerëson se Kosova ka nevojë për fushata sensibilizuese për rëndësinë e pjesëmarrjes së femrës në jetë politike dhe institucionale.

“Fushata emancipimi si për femrën ashtu edhe për mashkullin duhet të jenë të përshërme deri sa të arrihet ajo pikë kur femra do të jetë e barabartë në kuptimin e plotë të fjalës. Kur të arrihet kjo nuk do të kemi nevojë për kuota gjinore por do të kemi 50% femra në kuvend por edhe në institucionet tjera ekzekutive e publike”, ka përfunduar Rezarta Delibashzade.

Pavarësia ekonomike vazhdon të jetë një nga faktorët kryesorë për realizimin e të drejtës së barabartë për pozita vendimmarrëse. Nëpërmjet fuqizimit ekonomik llogaritet se femrat fitojnë dukshmëri dhe zë në familje, vendin e punës, komunitet dhe shoqëri. Edhe pse Kosova me përfaqësim gjinor në nivel vendimmarrje llogaritet e shtatëmbëdhjeta në botë, gjendja në tregun e punës mbetet akoma një sfidë.

Raporti meshkuj-femra

Sipas shifrave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës raporti meshkuj/femra është 96%. Për çdo 101.32 meshkuj ka 100 femra. Sa i përket arsimit, 60.6% e meshkujve përkundrejt 27.3% të femrave kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm të lartë. Kurse shkalla e papunësisë për gratë është 55,5% kundrejt meshkujve që është 40,5%. Ndërkaq, 49,4% e grave të punësuara punojnë në sektorin publik. 33.3% e grave zënë vend në Parlament.

Një dhomë për vete

Niveli dhe mënyra e zhvillimit të studimeve gjinore në Kosovë diktohen prej shumë rrethanave. Por, është jetike që kjo fushë të shndërrohet në vend të takimit të ideve, teorive, si dhe ballafaqimit të mendimeve dhe qasjeve të ndryshme

Luljeta Vuniqi

Shënimi i 10 viteve të punës së Qendrës Kosovare për Studime Gjinore është rast për reflektim jo vetëm në planin personal, për gjithë stafin e Qendrës, por është mundësi të shikojmë prapa dhe të shohim se si dhe sa ka kontribuar ky projekt në ndërtimin e dijes dhe njohurive feministe në Kosovë. Edhe pse pa përvojë në këtë fushë të re, por me disa modele dhe përvoja të mira nga rajoni dhe botë, gjatë këtyre viteve Qendra është përpjekur që me hulumtime, studime, analiza, hartime politikash, kurse ekstrakurrikulare, fushata, konferenca dhe avokime, t'i kontekstualizojë dhe t'i sjellë më afër ato përvoja rajonale dhe botërore, duke ofruar dhe fuqizuar argumentet feministe, pozicionin dhe mendimin feminist si mënyrë e veçantë e të menduarit karshi mendimit dhe dijes konvencionale.

Studimet Gjinore në Kosovë: perspektivat, kufizimet, sfidat

Pozicionimi i pavarur i Qendrës ka qenë përcaktim i cili i ka pasur përparësitë e veta, duke e bërë kështu të mundur që ta kemi lirinë për t'i zhvilluar në mënyrë autonome programet dhe projektet tona, të vendosim se cilat çështje të rëndësishme duam t'i ngrisim dhe t'i problematizojmë. Kjo liri e veprimt na ka mundësuar që të mbajmë lidhjen në mes të akademisë dhe aktivizmit, gjë e cila edhe është pasqyruar në shumë hulumtime, publikime dhe aktivitete të Qendrës ndër këto vite. Ky pozicionim ka sjellë akumulim të njohurive dhe informacionit shumë të vlefshëm. Por, siç argumenton edhe Jasmina Lukic në esenë e saj mbi pozitën e institucioneve të pavarura (jashtë institucioneve akademike) të studimeve të grave/studimeve gjinore në Kroaci dhe rajon, kjo ka bërë që studimet gjinore të mbesin në periferi kundrejt institucioneve mainstream dhe burimeve të pushtetit, që për konsekuencë ka dobësimin e ndikimit tonë në shumë aspekte, duke përfshirë këtu edhe çështjet të cilat kanë të bëjnë me statusin dhe rolin e dijes në shoqëri.

Megjithatë, më shumë se një arsye për festim dhe promovim të asaj çfarë ka kontribuar Qendra për 10 vite pune në zhvillimin e studimeve gjinore në Kosovë, ky është rast për të hapur një diskutim të munguar në Kosovë, një diskutim të çështjeve të ngutshme me të cilat ende nuk janë marrë seriozisht akteret e kësaj fushe: çështjen e një baze institucionale për studime gjinore, pozitën dhe relacionin në mes të njësisë/departamentit (ende në perspektivë) të studimeve gjinore në Universitet dhe institucioneve të pavarura të cilat veprojnë jashtë mureve të akademisë; mundësinë e shfrytëzimit të njohurive të mbledhura gjatë viteve në këtë fushë për zhvillimin e mëtutjeshëm të saj; vendin e studimeve gjinore midis disiplinave të tjera shkencore, si dhe sfidat e metodologjisë së mësimdhënies.

Niveli dhe mënyra e zhvillimit të studimeve gjinore në Kosovë diktohen prej shumë rrethanave, nga të cilat vlen të theksohen disa. Në Kosovë, ashtu si edhe në vendet e rajonit, studimet gjinore paraqesin një disiplinë të re, që ka ardhur si

rezultat i aktivizmit të fuqishëm të grave në vitet e '90'ta e më tutje, lëvizjes feministe dhe intereseve akademike të gjeneratave më të reja për format e kritikës feministe. Konteksti social, politik dhe ekonomik, problemet me zhvillimin e reformave arsimore, mungesa e njohurive, burimeve dhe interesimit të mjaftueshëm për këtë disiplinë, përgjithësisht kanë kushtëzuar dinamikën e zhvillimit të studimeve gjinore në Kosovë. Fakti se studimet gjinore nuk janë përfshirë si disiplinë në Regjistrin Kombëtar të Shkencës e bën gjithë procesin shumë të vështirë: akademikët/hulumtuesit nuk mund të fitojnë grada shkencore në fushën e studimeve gjinore, dhe kjo, për pasojë, e bën të pamundur përmbushjen e një nga kushteve themelore të nevojshme për të krijuar njësi-departament të studimeve gjinore në Universitetin e Prishtinës.

Për këtë arsye paradoksale, në mungesë të masave specifike legjislative që do ta rregullonin këtë çështje, studimet gjinore - të cilat duhet të shërbejnë si model për riorganizimin e hulumtimit dhe mësimdhënies në njësitë tjera në drejtim të aspektit ndërdisiplinar, në frymën e reformës së vazhdueshme të arsimit të lartë - nuk janë në gjendje për të vepruar në mënyrë të pavarur si disiplinë.

Kurthet e diskursit

Deri më tash, në institucionet akademike kosovare nuk ka pasur diskutime të rregullta mbi mundësitë, kufizimet dhe sfidat e studimeve gjinore në Kosovë.



Herë pas here, këto çështje janë ngritur në seksionet tematike të revistave të ndryshme kulturore dhe feministe, fillimisht në revistën Sfinga, e pastaj në publikimet e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, përfshirë edhe shtojcën e përvitshme Koha për Gratë, e së voni në revistën Njohja, që botohet nga Instituti për Studime Sociale dhe Humanistike, në Universitetin e Prishtinës, si dhe në revistën Kosovo 2.0. Kështu është ndërtuar një platformë - ndonëse e brishtë - për diskutime të studimeve gjinore.

Megjithatë, kjo fushë ende mbetet në margjinat e intereseve akademike dhe institucionale, duke u reduktuar shpesh në nivel të disa stereotipeve, argumenteve dhe qëndrimeve feministe të cilat kanë të bëjnë me seksualitetin femëror, qën-

dimeve kundër seksizmit, dhunës në baza gjinore, diskriminimit gjinor, klasor, etnik, racor, religjioz, etj. Tendencat e mitizimit mizogjenist të feminizmit si dogmë e një elite të grave të shtresës së mesme, apo si një stil jete, ose modë, e grave të moshës së mesme, e importuar nga shtetet perëndimore - është edhe një kurth i cili vjen nga shumë anë dhe dëmton zhvillimin e diskursit feminist.

Gjithashtu, mungesa e debeteve, komunikimit dhe shkëmbimeve të rregullta mbi zhvillimet, trendët dhe perspektivat e studimeve gjinore në rajon dhe botë, na lë jashtë diskursit aktual dhe e zvogëlon mundësinë e përfshirjes sonë në mënyrë kompetente në debatet kontemporane. Sa për ilustrim, diskutimi në mes shumë teoricienëve dhe feministeve botërore mbi çësht-

jen nëse lidhja e dikurshme në fillesat e studimeve të grave me lëvizjet feministe dhe rimishërimi i saj në studime gjinore, ka sjellë apo jo si pasojë shkëputjen e saj nga rrënjët e veta feministe, duke u larguar përfundimisht nga trashëgimia e dikurshme feministe si një lëvizje e cila gratë i ka subjekt të aktivitetit të vet politik dhe social - është diskutim që ka nevojë të shtrohet.

Temat si "Çfarë është feminizmi?", "Kush është feministe?", "Si e kuptojmë feminizmin përtej kufijve kombëtarë?", "Feminizmi mes kulturave", "Feminizmi nëpër kohë", janë pyetje të ngritura çdo ditë, si këtu dhe jashtë vendit, nga aktivistet në lëvizjet bashkëkohore të grave, nga studiuesit, në media, dhe në biseda joformale. Në përgjigjet e ndryshme nuk mungojnë as nuancimet politike dhe emocionale. Për shumë njerëz, brenda dhe jashtë akademisë, fjala "feminizëm" vazhdon të frymëzojë polemika kontraverse dhe mbase edhe të ndjellë frikë te një pjesë e publikut të gjerë. Shpesh, fjalët dhe konceptet që ata përcjellin lidhur me feminizmin mund të kenë konotacione të rrezikshme, rrjedhimisht edhe "feminizmi" dhe "feministet" duhet të jenë fjalë të rrezikshme, që përfaqësojnë koncepte të rrezikshme. Në këtë frymë, thelbi i kritikës jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon dhe në vendet e dala nga komunizmi, është në importimin dhe përvetësimin sipërfaqësor të ideve dhe teorive anglo-amerikane dhe franceze, të cilat e kanë pasur ndikimin më të fuqishëm në studimet gjinore.

Në këtë kuptim, Halina Filipowicz, hulumtuese polake, në mënyrë shumë të ashpër tërheq vëmendjen për transplantim të cekët dhe naiv të koncepteve perëndimore, duke mos e marrë parasysh kontekstin shoqëror-kulturor në të cilin ato u ngritën, dhe për mosmarrëveshjet dhe polemikat që ndodhin rreth tyre në qarqet e ndryshme. Si shembull ajo kujton teorinë e Judith Butler: koncepti i saj për gjininë si një "performansë e vazhdueshme", është marrë në Poloni dhe vende tjera te rajonit si një "fakt i padiskutueshëm", edhe pse ka qenë objekt i kontesteve dhe polemikave mes studiuesve amerikane për më shumë se njëzet vjet, duke e kualifikuar si një teori që "heq nga vëmendja problemin e subjektit konkret, duke bërë zgjedhje të rëndësishme në një situatë të veçantë historike".

Por, siç thotë Edward Said, "Njëjtë si njerëzit, edhe shkollat e kritikizmit, idetë dhe teoritë udhëtojnë - nga personi në person, nga situata në situatë, nga një periudhë në tjetrën... Lëvizja e ideve dhe teorive nga një vend në një tjetër është një fakt i jetës, por gjithashtu edhe një gjendje e dobishme që e bën të mundur aktivitetin intelektual".

Dhe kjo është saktësisht ajo që duhet ta bëjnë studimet gjinore: të shndërrohen në hapësira të krijimit të teorisë feministe, vend i takimit të ideve, teorive dhe praktikizmit, kryqëzimit dhe ballafaqimit të mendimeve dhe qasjeve të ndryshme.

Autorja është drejtoreshë ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore



Shikoni se si është zhveshur (Foto & Video)



Agon Maliqi

“Teprica e moralitetit çon drejt kriminalitetit!”, thotë Manu Chao në vargjet e njëres prej këngëve të tija më lozonjare, por tepër domethënëse, të quajtur “Promiscuity” (“Imoraliteti”). Muzikanti i shkëlqyer franko-spanjoll, i cili para disa vitesh pati koncert edhe në Prishtinë, e ironizon në këtë këngë njërin prej problemeve më esenciale të natyrës njerëzore: tensionin mes epsheve dhe dëshirave të individit, në njërin anë, dhe normave morale të cilat shoqëria njerëzore i ka zhvilluar përgjatë shekujve për t’i frenuar këto epshe dhe për të krijuar kohezion, në anën tjetër.

Ideja e këtij vargu specifik është që normat tepër të ngurta të imponuara nga shoqëria – si për shembull ato mbi seksualitetin – shpeshherë e arrijnë tek individit efektin e kundërt prej atij të synuar, duke e bërë të ndaluarën edhe më tërheqëse dhe më të dëshiruar, apo duke i shtyrë njerëzit drejt çmendurisë dhe thyerjes edhe më serioze të normave shoqërore.

Shembulli i parë që të bie në mend në këtë drejtim janë priftërinjtë e shumë katolik të cilët, të privuar nga jeta seksuale për shkak të dogmës fetare, u kthyen në masë drejt pedofilisë. Si shembull tjetër mund të merren edhe disa shtete islamike në të cilat liritë seksuale dhe të grave janë më të kufizuara në botë, por të cilat njëkohësisht janë vendet me numrin më të madh të vizitorëve të faqeve pornografike.

Shoqëria kosovare – me përjashtim ndoshta të një segmenti urban të Prishtinës – mbetet tejet konservative rreth çështjeve të së seksualitetit. Ato mbeten kontraverse sidomos në hapësirën publike, ku vazhdojnë ta ketë stigmën e diçkaje të turpshme. Por në mesin e popullsisë përgjithësisht të re kosovare megjithatë duket se po gjallon një energji e madhe dhe krejtësisht e

natyrshme seksuale, e cila po bëhet edhe më e madhe pikërisht për shkak se është e shtypur dhe e papërbushur.

Në një kohë kur kosovarët po bëhen gjithnjë e më të hapur ndaj botës perëndimore, dhe kur brezi i ri ka filluar të bëhet më liberal në praktikën seksuale dhe në shprehjet publike të seksualitetit – këtu sërish trendi është më i theksuar në Prishtinë –, në diskursin tonë publik është bërë edhe më agresive dhe e shfrenuar gjuha e atyre që e kanë marrë timonin për të qenë “mbrojtës të moralit dhe traditave”.

Natyrisht, objekt dhe obsesion i moralizuesve të tillë janë ekskluzivisht femrat me mendje dhe ambicie më të pavarur – të papërbushshme me traditën arkaikë! – por jo edhe meshkujt të cilët e shpërfaqin publikisht dhe pa pikë hezitimi agresivitetin e tyre seksual dhe misogjeninë. Në një shoqëri në të cilën diskursi publik është i dominuar nga meshkujt dhe i ndërtuar mbi parime thellësisht patriarkale, diskursi sekstit i meshkujve po legjitimohet si normal, sepse janë vetë meshkujt ata që e përcaktojnë se çka është normale. Dhe natyrisht, kur vjen puna te seksi, për meshkujt, epshe e tyre seksuale janë normale. Problemi janë “kurvat”.

U desh të vinte periudha e sotme e depërtimit masiv të internetit që ta vërtetohej edhe empirikisht përmasa e hipokrizisë së meshkujve moralizues kosovar. Të lë përshtypje fakti se në shumë prej portaleve të internetit, temat më të lexuara, përveç debateve fetare, janë zakonisht ato që në një formë ose tjetër e trajtojnë seksualitetin e femrës.

Shkoni në këtë moment në faqen e ndonjërit prej portaleve kryesore dhe diku do t’i shihni nja tre katër tema që ju premtojnë foto ose video intime të ndonjë figure publike femërore (të ngjashme me titullin e shkrimit tim), apo që kanë tituj sugjektiv seksual. Para disa javësh, në një periudhë të zhvillimeve të shumta të rëndësishme politike dhe sportive, tema më e lexuar e javës në njërin prej portaleve ishte “Seksi nga prapa: meshkujt e adhurojnë, femrat e sigurojnë orgazmën!”.

Redaktorët e këtyre portaleve, duke e pasur mundësinë për të parë



Përveç rrebeve misogjene të lexuesve të rëndomtë të portaleve, nuk mungojnë as në mesin gazetarëve shkrimet apo sulmet ndaj personazhet publike të gjinisë femërore të cilat nuk merren aspak me ndonjë çështje përmbajtjesore, por janë të mbushura me nëntekst apo edhe komente të drejtpërdrejta seksiste

se çfarë artikuj lexohen më shumë, i kanë kthyer faqet e tyre në dispozicion të kërkesës, duke e krijuar kështu pasqyrën më të mirë të tensionit dhe energjisë së papërbushur seksuale të mashkullit kosovar. Për më tepër, ata i kanë kthyer këto portale në platformën ku ushqehet gjuha më e ulët e urrejtjes dhe poshtëritimit ndaj vajzave dhe grave, nga moralizuesit të cilët

“krejt rastësisht” ndodhen duke lexuar artikuj me përmbajtje të natyrës seksuale.

Ky fakti i fundit dëshmon se gjuha moralizuese të shumtën e rasteve nuk ka të bëjë aspak me tradita dhe as me fe, por është vetëm një mbulesë racionalizuese për mospërbushjen seksuale të mashkullit kosovar. Nëse do ta përdornim terminologjinë e ligjit themelor të

ekonomisë, do të thoshim se oferta aktuale në një shoqëri shtypëse ndaj seksit dhe lirisë së femrave e krijon një situatë në të cilën nuk mund të përmbushet niveli i kërkesës dhe i epshit të meshkujve. Këtu pastaj hyn edhe ajo predispozita psikologjike e njerëzve për ta bindur veten se qershia e cila nuk mund të arrihet është ashtu kështu e keqe. Apo edhe se duhet shtypur! “Kurvat e drejt!”

Përveç rrebeve misogjene të lexuesve të rëndomtë të portaleve, nuk mungojnë as në mesin gazetarëve shkrimet apo sulmet ndaj personazhet publike të gjinisë femërore të cilat nuk merren aspak me ndonjë çështje përmbajtjesore, por janë të mbushura me nëntekst apo edhe komente të drejtpërdrejta seksiste. Më skandaloz nga të gjithë ishte një artikull i botuar para disa javësh në njërin prej portaleve tona, i cili përveçse nuk raportonte për kurrfarë lajmi me rëndësi, por për një postim të një zyrtareje qeveritare në Facebook, insinuoonte në marrëdhëniet e saja seksuale me persona të racës së zezë!

Problemet me raportet gjinore dhe me agresivitetin e meshkujve seksualisht të papërbushur do të jenë në mesin tonë edhe për një kohë të gjatë. Këto janë probleme të cilat zgjidhen vetëm me zëvendësimin e brezave, si me sakrificat e shumë vajzave dhe grave të cilat do të duhet të mbeten stoike në angazhimet publike, duke u përballur me një ambient agresiv, gjykues dhe poshtëruar. Në këtë drejtim është shumë e rëndësishme që atyre t’u dilet në ndihmë përmes mbrojtjes publike dhe inkurajimit për të mos u tërhequr përballë horrave të shumtë misogjen.

Ndërsa një mënyrë konkrete se si shteti do të mund të ndihmonte është që përmes institucioneve të tija rregullatore të sanksiononte dënime të ashpra për gjuhën e përdorur nga gazetarët dhe lexuesit e portaleve. Kjo sepse legjitimimi i gjuhës misogjene në diskurs publik po vazhdon ta ushqejë atë mentalitetin dominues arkaik i cili para dy vitesh çoi deri te vrasja e Diana Kastriotit nga ish-burri i saj, “për çështje të nderit!”. Siç do të thoshte Manu Chao: “Teprica e moralitetit çon drejt kriminalitetit!”

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME GJINORE KUNDËR MARTESAVE TË HERSHME

Kundër 16 vjeç nuse

Selvije Bajrami

I ka 27 vjet, por 13 vjet martesë. Është kjo Mendije Feka nga Fushë-Kosova. Ajo është nënë e tre fëmijëve dhe jetën e saj e ka rrëfyer në një film dokumentar që është shfaqur verën e vitit të kaluar në Prishtinë. Feka i takon komunitetit RAE në Kosovë. Ajo në këtë film ka shpjeguar se ishte martuar, pasi ishte grabitur nga burri i saj.

Por, në Kosovë mund të martohesh posa t’i mbushësh të 16-at, dhe për këtë nuk nevojitet grabitja.

Asgjë nuk mund ta ndalë martesën posa t’i mbushësh të gjashtëmbëdhjetat, përfshirë edhe ligji. Ligji për familjen e lejon një gjë të tillë, ani pse po kërkohet që të ndryshohet dhe të mos lejohet martesë e personave nën moshën 18-vjeçare.

Ndonëse në pikën e parë të nenit 16 të këtij ligji bëhet me dije se në Kosovë nuk mund të martohet personi pa i mbushur të tetëmbëdhjetat, pika pasuese e të njëjtit nen e legjitimon të kundërtën.

“Për shkaqe të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t’i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse kon-

staton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore”.

Ky nen iu ka rënë në sy shumë personave, por deri më tani nuk është bërë. Pak të tillë kanë kërkuar që ky nen të përjashtohet nga ligji dhe si i tillë ligji të amendamentohet. Por, një kërkesë e tillë është bërë tashmë vonë nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Por, derisa ky nen vazhdon të jetë në ligj, shumë persona e kanë shfrytëzuar e po e shfrytëzojnë dhe si të tillë janë martuar e vazhdojnë të martohen në moshën që vlerësohet të jetë e papjekur.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore javë më parë e ka publikuar hulumtimin ku shihet qartë se martesat e hershme janë shumë të pranishme në Kosovë.

“Botëkuptimi ose ideja është që ato janë legjitime edhe normale, edhe bile të dëshirueshme, sepse konsiderohet ende që sa më herët të lindin vajzat është ma mirë e ma shëndetshëm”, shfaq shqetësimin e saj Luljeta Vuniqi, drejtoreshë e Qendrës.

“Brengosës është fakti se një gjë e tillë është e rregulluar me ligj”, ka

thënë Vuniqi, teksa ka shtuar se nuk dihet saktë se sa është numri i këtyre martesave.

“Tek ne ende martesë legjitimohet me dasmë. Çifti thjesht e bën ceremoninë, martohen, ndonëse të rinj, dhe kur ta mbushin këtë moshë shkojnë e kurorëzohen”, thotë Vuniqi, teksa bën me dije se Qendra e ka paraqitur kërkesën për largimin e tërësisht të këtij neni nga ligji.

Por Besim Kajtazi, udhëheqës i Zyrës ligjore në Qeveri, thotë se ndonjë kërkesë eventuale nuk i ka rënë në sy, ani pse personalisht, edhe ai, ndan mendimin që ky nen duhet të largohet.

“Sidoqoftë, për momentin Qeveria nuk është duke bërë ndryshime në Ligjin e familjes. Por, kjo çështje pritet të rregullohet me kodin civil. Kodi civil është një nismë që po diskutohet të bëhet, por që merr kohë deri në 1 vit e gjysmë. Ky kod përfshin deri në 20 nene, ku ndërto përfshihet edhe çështja e martesave. Pra, çdo gjë që ka të bëjë me të gjitha marrëdhëniet civile. Edhe ky është një projekt, një nismë e përbashkët me Komisionin Evropian, dhe për momentin jemi në fazën e diskutimeve”, ka thënë Kajtazi.



Janë dhjetëra martesë që në Kosovë personat kanë bërë pa i mbushur të 16-at. Të gjithë e ndajnë mendimin për largimin e nenit që e legjitimon atë, por procedurat ende nuk kanë nisur

BISEDË ME KRYETARIN E PRISHTINËS, SHPEND AHMETIN, PËR PËRPARIMIN E POZITËS SË GRUAS

Ahmeti: Fuqizimi i grave ndër projektet e para të Prishtinës

Për pozitën e gruas në vendimmarrje, kryetari i Prishtinës, Ahmeti e ka pranuar se ai numër nuk është I kënaqshëm. Ai nuk ka dhënë ndonjë arsye, por është zotuar se gjatë mandatit do ta ndryshojë gjendjen

Ganimet Klaiqi

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në një bisedë për nder të 8 Marsit-Ditës ndërkom-bëtare të gruas është zotuar se si qeverisje komunale do të mundohen maksimalisht që ta forcojnë pozitën e gruas, jo vetëm në vendimmarrje por edhe në ngritjen e tyre ekonomike. Madje, ai ka thënë se kjo do të jetë prioritet i tij dhe qeverisjes në krye të së cilës është. Madje, ai është shprehur krenar që një ndër projektet e para të kësaj komune ka qenë për fuqizimin ekonomik të grave dhe përforcimi e pozitës së saj në shoqëri përgjithësisht. “Komuna e Prishtinës ka filluar punën në fuqizimin e grave në ekonomi. Në propozimprojektet e para që kemi dërguar edhe ne Komisionin Evropian për tregjet vendore lokale, bashkëpunimin e kemi bërë me organizatat që merren me fuqizimin e grave në ekonomi”, ka thënë ai, ndërsa ka shtuar se si komunë do të marrin pjesë në trajnimet e organizuara për buxhetimin gjinor. “Për këtë, si kryetar komune i kam obliguar të gjithë drejtorët që të marrin pjesë”, është shprehur ai. Ahmeti në lidhje me fuqizimin e grave nuk ka premtuar se do t'i mbështes ato me grante të vogla për fillimin e bizneseve, apo se do t'i shkurtojë taksat për vitin e parë të operimit formal të bizneseve të grave, por ka theksuar se kanë menduar për lidhjen e disa projekteve me punësimin e grave.

“Ideja për shujtat e klasave 1 – 5 të shkollave fillore që mendojmë ta fillojmë në shtator do të lidhet me punësimin e grave në zonat ekonomikisht më të varfra. Me këtë do t'i targetojmë ato zona, që të mundësojmë fuqizimin e grave”, është shprehur Ahmeti. Në këtë




Foto: Driton Paçarada

Kryetari Ahmeti ka theksuar se do ta rrisin bashkëpunimin me OJQ-të për të drejtat e grave dhe organizatave që merren me barazi gjinore. Po ashtu ka theksuar se do t'i mbështesin femrat në luftë kundër dhunës në familje, në projektet që mundësojnë reintegrimin dhe reabilitimin e grave ndaj të cilave është përdorur dhunë etj.

rrafsh, Ahmeti është ndalur edhe tek përmirësimi i kushteve, përkatësisht zgjerimin e çerdheve për fëmijë, me qëllim që ato të kenë ku t'i dërgojnë fëmijët e tyre.

“Çerdhet janë një prej prioritetve kryesore të qeverisjes në Prishtinë dhe se të gjitha përgatitjet po shkojnë sipas planit të cilin edhe e kemi shpalosur në fushatë. Kjo ka të bëjë me planifikimin e nevojave dhe hartimin e planit aksional”, ka theksuar ai teksa ka shtuar se kjo do të bëhet edhe me një model kreativ që nuk është zbatuar ndonjëherë në Kosovë por që është marrë si model nga disa shtete të zhvilluara evropiane dhe

që, sipas tij, do të jetë një ndihmë e konsiderueshme edhe për gratë e reja të cilat janë në vende të punës. “Të gjitha këto do t'i zbulojmë më vonë gjatë këtij muaji”, ka theksuar ai.

Për zhvillimin e politikave sociale, që kanë të bëjnë edhe me përmirësimin e pozitës së gruas, Ahmeti ka folur pak pasi që sipas tij ato janë në përgjigjësi të organeve qendrore.

“Jemi duke i rishikuar të gjitha politikat sociale të cilat janë në kompetencë të komunës, por shumica e këtyre politikave i përkasin qeverisë”, ka thënë ai. Për pozitën e gruas në vendimmarrje, ndërkaq,

Ahmeti e ka pranuar se ai numër nuk është i madh.

“Në përgjithësi numri i vajzave dhe i grave në vendimmarrje nuk është i madh. Këtu mund të them se as si Komunë e Prishtinës nuk jemi në një pozitë më të mirë”, ka theksuar Ahmeti. Mirëpo, në këtë fushë ai ka premtuar se deri në fund të mandatit të qeverisjes do të bëjnë ndryshime të konsiderueshme.

“Synimi është që deri në fund të mandatit të rrisim dukshëm, por jo vetëm duke u bazuar në kuota por më shumë në cilësinë e kandidatëve të ndryshme për pozita”, ka potencuar Ahmeti duke shtuar se sa i për-

ket obligimit dhe statistikave do të raportojnë në të ardhmen.

Ndërkaq, i pyetur se a do të krijojë komuna ndonjë fond të veçantë cili do të ndikonte më shumë në mbështetjen e grave i pari i Prishtinës ka theksuar se nuk do ta bëjnë një gjë të tillë. “Nuk besoj se do të krijojmë një fond të veçantë, sepse nuk mendoj se ka nevojë për fonde të tilla”, ka pohuar ai.

Ndryshe ai ka theksuar se do ta rrisin bashkëpunimin me OJQ-të për të drejtat e grave dhe organizatave që merren me barazi gjinore, se do t'i mbështesin ato që të mos ketë dhunë në familje, në projektet që ofrojnë shërbime të cilat mundësojnë reintegrimin dhe reabilitimin e grave ndaj të cilave është zhvilluar dhunë dhe janë vendosur në strehimore.

“Jemi duke diskutuar me disa organizata joqeveritare që merren me këtë problematikë për të parë se sa mund të ndihmojë komuna në fushat ku ka kompetenca”, ka thënë ai dhe ka treguar se në Prishtinë janë disa strehimore. “Ne kemi strehimore në Prishtinë, por që momentalisht kanë pak përfaqësues nga komuna. Dë të shohim mundësinë e rritjes së kesaj përfaqëseje në të ardhmen”, ka premtuar ai. Përkritazi me mbështetjen e artisteve dhe krijueseve të reja Ahmeti është shprehur kundër dalimeve të tilla. “Nuk mendoj se duhet të bëjmë dallime të tilla. Në duhet të përkrahim artin dhe kulturën pa marrë parasysh gjininë, sepse kjo është e nevojshme për qytetin tonë e besoj se në të ardhmen përkrahja nuk do të mungojë për artin në përgjithësi”, është shprehur ai me konstatimin se në Prishtinë po vijnë ditë të mira për të gjithë, por pa diskriminime.

BISEDË ME AKTIVISTEN E SHOQËRISË CIVILE ARIANA QOSAJ-MUSTAFA

Mungesa e mbështetjes institucionale, sfidë për OJQ-të e grave

Blerta Aliu

Organizatave e shoqërisë civile që merren me çështje të grave nuk kanë përkrahje adekuate. Madje edhe për ato më aktivet, sfidë mbetet pagesa e një qiraje për zyrë për shkak të problemeve të shumta financiare. Mungesa e një vullneti politik të mirëfillt për t'i mbështetur këto organizata dhe gratë në përgjithësi, konsiderohet si një prej problematikave kryesore që po e stagnon fuqizimin e gruas në Kosovë.

Ariana Qosaj-Mustafa, kryetare e bordit të Rrjetit të grupit të grave, që aktualisht i ka të anëtarësuara 71 organizata joqeveritare që merren me çështjen e gruas, pohon se sfidë kryesore për të realizuar prioritetet e tyre mbetet mungesa e mbështetjes. Një përkrahje formale e Qeverisë, sa për të plotësuar standardet e BE-së, së bashku me një mentalitet shoqëror patriarkal thotë se po ndikojnë që femrat të anashkalojnë nga vendimmarrja dhe adresimi i projekteve dhe nevojave që ato kanë.

Por edhe ato gra që janë në vendimmarrje konsideron se nuk kanë bërë aq sa duhet dhe aq sa kanë mundur të bëjnë në adresimin e çështjeve që lidhen me gjininë femërore. “Në këtë legjislaturë e fundit në Kuvendin e Kosovës gratë kanë qenë më aktive sesa në të kaluarat. Por mendoj se kanë mundur të jenë më proaktive. Ato kanë reaguuar sipas nevojës dhe mendoj se kanë mundur të tregojnë një solidaritet të vazhdueshëm me

OJQ-të dhe jo vetëm atëherë kur ka pasur ngjarje të caktuara”, ka thënë ajo.

Sipas, Qosaj-Mustafës, këto gra që kanë marrë mandatin për shkak të kuotës, do të duhej të kujtoheshin më shpesh për çështjet që kanë të bëjnë me gratë. “Debatet në Kuvend për çështje të grave janë shumë të rralla. Ato nuk solidarizohen në votim ani pse i kanë 30 për qind të votave dhe nuk i shfrytëzojnë për interesa të grave, për shëndetësi, arsim e çështje tjera që e ndikojnë jetën e përditshme të grave dhe familjes. I kanë agjendat e liderëve të tyre politik dhe nuk duan të solidarizohen”, ka shtuar ajo.

Të pa interesuar në këtë drejtim e sheh edhe nivelin komunal, pasi që përveç premtimeve ashtu si niveli Qendror, nuk ka lëvizur asgjë drejt konkr-

etizimit të mbështetjes. “Kemi marr shumë premtime nga institucionet, edhe nga qeverisja lokale e kaluar në Prishtinë po nuk është realizuar. Kemi mbetur tash me këtë aktualitet, është tregu një vullnet i mirë, por të shohim a ka realizim”, ka thënë ajo.

Qosaj-Mustafa, tregon se pikërisht në 2011-ën Rrjeti i grupit të grave për shkak të mospërkrahjes kishte qenë në prag të mbylljes së zyrave.

Edhe bashkësia ndërkombëtare që është prezente në Kosovë thotë të ketë kontribuar pak për çështje të grave, ani pse ka premtuar shumë në këtë drejtim.

“Ne duam një shoqëri ku kemi shanse të barabarta. Femra të jetë faktorë potencial i ndryshimit dhe zhvillimit”, ka potencuar ajo. Por ndihma e donatorëve të huaj thotë se po

i mbanë ende aktiv pasi që shumicën e kontributit e japin organizatat e huaja. Edhe ndihmesa individuale nga njerëz vullnetar thekson se kanë kohë pas kohe.

Ky rrjet i cili ka filluar punën qysh nga viti 2000, sipas saj, punën e ka të koncentruar në disa shtylla apo programe që janë të përcaktuara në bazë të strategjisë që ka. Aty hyjnë: gratë në vendimmarrje, fuqizimi ekonomik i grave, programi kundër dhunës në baza gjinore, kundër dhunës në familje e trafikimit të qenieve njerëzore, ngritja e kapaciteteve të rrjetit etj.

Puna e tyre thotë se varet edhe nga nevojës dhe kërkesës e OJQ-ve për përkrahje.

Ndërkaq strategjia e këtij rrjeti tregon se hartohet në bashkëpunim me vet organizatat. “Kemi një kuvend vjetor që është final në çdo fundvit në të cilin merren vendimet më të mëdha. Zakonisht edhe për përzgjedhjen e anëtarëve në bord. Pastaj merren edhe vendime që kanë të bëjnë me aktivitetet e punës. Shikohet cilat kanë qenë të arritura dhe orientimet në të ardhmen”, ka sqaruar ajo.

Ky rrjet thotë se në kuadër të ak-

tiviteteve dhe punëve që ka, u ka dhënë grante të vogla OJQ-ve që merren me vetëdijësimin e grave apo ato që merren me prodhimtari të vogla. Po ashtu ka bërë edhe humltime në sferën e të drejtave të grave. “Kemi botuar shumë për çështjen e dhunës në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, sigurinë në shtëpi etj.”, ka thënë ajo.

Qosaj-Mustafa, tregon se Rrjeti i grupit të grave kontribuon shumë edhe në avokim. Përkritazi me këtë thotë se shumë herë kanë qenë pjesë e grupeve punuese për hartimin apo amandamentimin e ligjeve që kanë të bëjnë me gratë. “Rrjeti bënë shumë në përfaqësimin e të drejtave të grave jashtë Kosovës. Shembull në rajon, ka qenë Lobi i grave rajonale ku janë përkrahur gratë në politikë”, ka sqaruar ndër të tjera ajo.

Këtë vit ashtu si edhe viteve para-prake, tregon se është caktuar tema qendrore në kuadër të së cilës do të punohet dhe avokohet përgjatë tërë vitit e që ka të bëjë me drejtësinë ndaj viktimave. E gjatë vitit që shkoj kishin qenë të fokusuar tek shëndetësia.

Ndërsa edhe në të ardhmen vlerëson se ky rrjet do të vazhdojë të punoj sipas strategjisë që ka. Tashmë thotë se kanë filluar të përkrahin edhe grupe të vajzave të reja feministe. “Kjo ka ardhur si kërkesë e këtyre vajzave dhe ka qenë interesante. Sadoherë që kërkojnë ndihmë i përkrahim pasi që kanë ide, kanë qasje të re, janë kreative dhe po na pëlqen që t'i përkrahim”, ka bërë të ditur ajo.



Ariana Qosaj-Mustafa, kryetare e bordit të Rrjetit të grupit të grave, që aktualisht i ka të anëtarësuara 71 organizata joqeveritare që merren me çështjen e gruas, pohon se sfidë kryesore për të realizuar prioritetet e tyre mbetet mungesa e mbështetjes

Fertiliteti marketing për ta përmbushur rolin shoqëror

Blerta Aliu

Të njohurit e trupit, konsiderohet një prej çështjeve elementare për secilin. Megjithatë gratë kosovare “kanë ende probleme serioze” në këtë sferë si pasojë e mosinformimit. Përderisa reklamat që kanë të bëjnë me fertilitet dominojnë në tregun kosovar, studiuesit e këtyre çështjeve e shohin si më të nevojshëm informimin rreth edukimit seksual, shmangies së infeksioneve seksuale, vizitave tek gjinekologu, kontrolleve të gjirit e çështjeve tjera që lidhen me shëndetin e gruas.

Antropologia, Nita Luci, konsideron se po bëhet shumë pak për shëndetin e gruas. Ndërkaq ato reklama që po servohen nga institucione të ndryshme shëndetësore për çështje të asistencës në riprodhim edhe pse i përgjigjen një kërkesë, vlerëson se nuk duhet të jenë e gjitha çfarë duhet të bëhet për gratë. “Kërkesa tek ne nuk është vetëm për produktin që shitet që në këtë rast është mbarsimi, por këtu në të vërtetë shitet diçka tjetër. Ajo që na reprezentohet neve me ato reklama është roli kulturor që ka të bëjë me pritshmërinë e të gjithë neve, që ne të mundemi me krye atë rol, me e përmbush atë rol shoqëror që na kërkohet”, ka thënë ajo. Luci e sheh si diçka “interesante”, mënyrën se si vizuelisht apo edhe në formë tjera plasohet një ofertë që ka të bëjë me asistencë në riprodhim nga institucionet shëndetësore.

Çdo herë thotë se është gruaja ajo që paraqitet si nevojtare për një asistencë të tillë, ani pse statistikisht sipas saj, janë meshkujt ata tek të cilët “qëndron problemi”. “Ne nuk shohim reklama ku një burrë ka një fëmijë në dorë dhe është i lumtur që i është ofruar ky shërbim dhe më në fund e ka bërë fëmijën. Por ajo që po na paraqitet është gruaja si agjent i riprodhimit, ajo që duhet me krye rolin e vet si nënë për ta arritur edhe atë rolin shoqëror që kërkohet prej


saj por edhe atë emotiv”, ka thënë ajo.

Tërë kjo thotë se ka të bëjë me ndarjen e roleve gjinore, pasi që shumë më tepër flitet për amësinë sesa për atësinë. “Pritjet amënore janë temë më e madhe e diskutimit, janë edhe temë e ndëshkimeve shoqërore. Shumë pak flitet për atësinë”, plotëson ajo.

Andaj Luci konsideron se duhet të investohet më shumë në reklama e fushata që kanë të bëjnë me njohjen e trupit dhe shëndetin e gruas në përgjithësi.

Edibe Hoda-Borovci, gjinekologe në një spital privat, i cili ndër të tjera ofron edhe shërbime që kanë të bëjnë me mbarsime artificiale, thekson se reklamimi që i bëhet kësaj çështje vjen si rrjedhojë e kërkesës dhe interesimit. “Fekondimi artificial është çështje që lind si nevojë tek çiftet që nuk arrijnë konception natyral apo shtatëzani natyrale. Ndjenja për të qenë prind është e paevitueshme. Ne si mjek e kemi për detyrë që të hulumtojmë deri në fund për një shtatëzani normale derisa nuk shohim asnjë mundësi dhe pastaj janë çiftet që vendosin për mënyrën tjetër”, ka thënë ajo. Hoda-Borovci ka treguar se zakonisht gratë që i nënshtrohen procedurave të tilla janë mbi moshën 35 vjeçare të cilat minimum kanë gjashtë vite që nuk arrijnë konception natyral. Duke shpjeguar një prej metodave për realizimin e një fekondimi të asistuar siç është IVF, ajo ka thënë se është një metodë që po u bënë zgjidhje prindërve. Por se sa është e sigurt se do të rezultojë pozitivisht, thotë se “është krejtësisht individuale që varet nga organizimi i secilit”.

Faik Hoti, zëdhënës i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), lidhur me shëndetin e gruas dhe përpjekjet për ta përmirësuar atë thotë se kjo ministri ka krijuar Divizionin për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Ky divizion i koordinon aktivitetet që



Edibe Hoda-Borovci, gjinekologe në një spital privat, i cili ndër të tjera ofron edhe shërbime që kanë të bëjnë me mbarsime artificiale, thekson se reklamimi që i bëhet kësaj çështje vjen si rrjedhojë e kërkesës dhe interesimit

kanë për qëllim përmirësimin e shëndetit të grave”, pohon ai.

Deri më tani tregon se është har-

tuar dhe aprovuar Strategjia për shëndetin e nënës, fëmijës, adoleshentëve dhe shëndetit riprodhues, në

kuadër të së cilës shumë prej objektivave lidhen me përmirësimin e gjendjes shëndetësore të nënave-grave. “Për Ministrinë ka qenë dhe mbetet shumë prioritet sigurimi i kushteve për amësi të sigurt, planifikim familjar, parandalim të kancerit të formave të ndryshme, parandalim të infeksioneve seksualisht të transmetueshme, trajtimi i infertilitetit, të sigurohet barazia gjinore dhe të parandalohet dhuna në familje”, ka thënë ai.

Ai e pranon që duhet dhe se ka vend të bëhet më tepër në vetëdijësim. “MSH-ja mund të ndihmohet edhe nga segmente të tjera siç është shoqëria civile sikur ka bërë shembull me Ligjin për Kontrollin e Duhurit, i cili gjithashtu është një kontribut edhe për shëndetin e grave duke ditur se në bazë të dhënave të një hulumtimi të Zyrës së OBSH-së në Kosovë, duhanpirja te shtatzënat ka qenë rreth 21 për qind”, ka pohuar ai. Por janë fondet ato për të cilat thotë se kjo ministri ka nevojë në mënyrë që t’i realizoj fushatat vetëdijësuese.

Ndërkaq reklamat, që bëhen nga kompani dhe spitale të ndryshme private që kanë të bëjnë me fekondimet artificial, sipas Ligjit të Shëndetësisë, Hoti thotë se janë të ndaluara. Spitalet sipas tij mund të reklamojnë shërbimet e tjera mjekësore, për të cilat kanë licencë të ofrimit të tyre.

Me tej tregon se MSH-ja ka bërë disa aktivitete e fushata për zvogëlim të shkallës së vdekshmërisë perinatale të grave, të anemisë tek shtatzënat, janë hartuar broshura për parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme siç është HIV/AIDS-i , kundër kancerit të qafës së mitrës, kundër kancerit të gjirit etj.

Sa i përket fushatës kundër kancerit të gjirit thotë se është në përgatitje një fushatë e re me rastin edhe të futjes në funksion të mamografit mobil.

PËRFAQËSIM SOLID I FEMRËS NË INSTITUCIONET E KOSOVËS

Femrat duan më shumë se përfaqësim statistikor në institucione

Ganimet Klaiqi

Anëtarja e Kuvendit Komunal të Prishtinës, njëherësh doktore në shkencën e letërsisë, Vjollca Dibra-Ibrahimi, s’është e pajtimt që femra kosovare, në kuptimin e pjesëmarrjes në institucione të trajtohet në përqindje, 20, 30, apo 50 për qind. Për atë rëndësi ka cilësia që duhet ta krijojnë edhe femrat, me qëllim që ato natyrisht të jenë të barabarta. “Nëse pyesim tani se mos ndonjëherë kuota 30 për qind e dëmtos procesin zgjedhor, padyshim do të thosha po, ngaqë përzgjedhja shpesh nuk i nënshtrohet cilësisë, por statistikës”, thotë Dibra teksa e cilëson zhgënjyese për të gjithë ata që presin ndryshime reale në këtë vend, “kur kuota është mekanizmi i vetëm që i obligon partitë të mendojnë edhe për përfaqësimin e femrave”. “Po të nisem nga përvoja personale, duke qenë me mandat të dytë në KK të Prishtinës mund të them se vështirësitë janë përherë të pranishme, por këtë e shoh si një sfidë, kalitje dhe sprovë të domosdoshme për t’u dëshmuar”, ka thënë Dibra. Ajo thotë se për 4 vjet sa ka punuar s’i ka përfillur sfidat dhe vështirësitë, sepse ka qenë e motivuar me një dozë idealizmi dhe aspirata prosperuese.

“Njeriu, në rastin konkret gruaja duhet t’ia vendosë vetes një qëllim prandaj do të arrijë gjithçka”, duke e pasur në plan të parë edhe mbështetjen e bashkëpunëtorëve dhe të familjes. Dibra thekson se në mandatin e parë ishte e përqëndruar në Komitetin për Arsim, si zëvendëskryesuese dhe në Komisionin për Emërtimin e Rrugëve. Ndryshe, ajo ka theksuar si u përket grave që zgjedh luftën për prosperitetin dhe statusin e vet në shoqëri.

“Kur flasim për femrën duhet pasur parasysh situatën e saj si grua e martuar, si nënë, si pjesëmarrëse në jetën shoqërore. Tek ne, deri vonë, një numër i madh i femrave, me hyrjen në martesë i nënshtrohen tendencës për humbjen e identitetit të e saj, duke e adaptuar jetën e saj sipas kërkesave të bashkëshortit. Me ndryshimet që pasuan mbi bazë të evolimit shoqëror kjo prirej mori kahe pozitive”, shpreh Dibra sipas të cilës diku-diku kjo eksperiencë ishte më sfiduese. Por, sipas saj, procesi i vetëdijësimit solli edhe konceptin e ri të mbështetjes së partnerëve tek njëri-tjetri. “Vetëm një mirëkuptim i tillë mund t’i hapë dyert ardhmërisë së suksesshme Gruaja ka nevojë për ndërtimin e komunikimit mbi bazën e harmonisë. Së këndejmi, nuk shtrohet çështje nëse është e lehtë a e vështirë barazia e gruas me burrin, por është çështje parimesh e domosdoshmërie”, është e bindur ajo me konstatimin se këto janë standarde ndërkombëtare, universale dhe qytetëruese. Dibra mendon se janë përkrahja dhe besimi që duhet dhënë pa kushte femrës, po aq sa edhe ajo vetes.

“Është vështirë objektivisht të bëhet dallim mes një gruaje dhe një burri të cilët jetojnë në rrethana të ngjashme sociale dhe politike, por është po aq vështirë të thyhen konceptet konservative dhe perceptimet në këtë plan. Mu këtu e shoh arenën e luftës, gjithnjë duke u shprehur figurisht sipas vokacionit tim letrar. Ndonjëherë më rritet shpresa dhe ndihem më optimiste kur shoh se nuk mungon vlerësimi edhe nga pala tjetër”, shpreh Dibra me konstatimin se për asnjë çast nuk e amnistion ngurtësinë dhe statusin e lëmoshës ose të mëshirimt.

“Statusi ynë nuk kërkon përkëd-

heli përcmuese, tolerancë false, por drejtësi dhe ballafaqim të dinjitetshëm. Fundja, verdikti i votës është përgjegjësi dhe detyrim”, përfundon Dibra.

Bunjaku: 30 përqindëshi do të jetë i harruar

Kryesuesja e KK-së në Gjilan, Valentina Bunjaku, mendon se 30 përqindëshi i pjesëmarrjes së femrave në institucione duhet të harrohet.

“Kuota e përfaqësimit gjinor tek ne duhet të ekzistojë, por ne femrat duhet të bëjmë më shumë që përfaqësimi të jetë konform asaj që na takon, ne duhet të punojmë që 30% mos të na falin, por të fitojmë 50% e merituar, ngase gjysma e popullatës së Kosovës i përket gjinisë femërore”, ka theksuar ajo. Bunjaku thekson se femrat po punojnë në institucione që zëri i tyre të jetë zë i së vërtetës.

“Me punën tone, besoj që do të arrijmë që në një të ardhme të afërt kuota e 30 % të jetë diçka e harruar, ngase çdo ditë e më shumë femra po tregon vlerat e saj të mirëmenaxhimit dhe të sukseseve. Kjo do të ndikojë në përmirësimin e pozitës së gruas në shoqëri”, është shprehur ajo.

Sa i përket pjesëmarrjes së gruas në zhvillimet e përgjithshme në Kosovë, ajo mendon se krahas demokratizimit ka zënë të përmirësohet edhe roli i gruas në shoqëri. Sipas saj agresiviteti i politikës gjatë periudhave zgjedhore shpesh i ka detyruar femrat të mos përfshihen në procese të vendimmarrjes.

“Zgjedhjet e fundit thuajse ishin një sinjal më i mirë nga ku u dha një mesazh se edhe tek ne gjithçka po

shkon drejt konsolidimit të demokracisë. Besoj se shumë shpejt rrjedhat do të vihen në binar të duhur dhe femra do të jetë e përfaqësuar denjësisht në të gjitha segmentet e jetës institucionale”, është shprehur ajo dhe ka shtuar se ka shumë raste që femrat kanë treguar suksese në udhëheqje: me iniciativa private, në biznese prodhuese etj. “Ato po arrijnë të tregojnë histori suksesi”, konstaton Bunjaku.

KK-të ruajnë 30 përqindëshin e përfaqësimit

KK i Prishtinës si kryeqytet, midis 51 këshilltarëve përfaqësohet me 17 këshilltare. LDK-ja, midis 18 anëtarëve të KK-së, i ka 5 femra, që i bie pak më shumë se 30 për qind. VV-ja, nga 10 këshilltarë është me 3 femra, më pak se kuota, PDK-ja me 8 këshilltarë i ka 3, AAK-ja me 4 delegatë i ka 2 me 2, AKR, një midis 4 delegatëve, LB-ja një me një dhe kaq. Edhe Peja si qendër rajonale midis 41 këshilltarëve i ka 13 femra të përfaqësuar. Gjilanin ka gjithsej 11 këshilltare femra në Kuvendin Komunal. Kryesuesja është Valentina Bunjaku-Rexhepi. Në ekzekutiv është vetëm një drejtoreshë, Labinota Demi Murtezi e cila e drejton drejtorinë e Shëndetësisë. Kuvendi komunal i Ferizajt midis 41 këshilltarëve femra janë 19 femra. Është përfaqësimi më i madh në krejt Kosovën. E ka tejkluar edhe 40 përqindëshin.

Në ekzekutiv janë dy drejtoresha: Drejtorja për financë Lirije Sylja (LDK) dhen Drejtorja për zhvillim ekonomik dhe turizëm Mimoza Fazliu. Gjajkova me kryetaren femër, ndërkaq, midis 35 këshilltarëve i ka

12 femra, 30 për qind. Në Mitrovicë, midis 35 anëtarëve të Kuvendit janë vetëm 10 femra, që i bie se nuk është arritur as 30 përqindëshi. KK i Podujevës i ka 11 këshilltare femra nga 35 sa është numri i përgjithshëm. LDK e ka saktë një të tretën 5 në 15 këshilltarë, PDK: 4 nga 12 e kështu me radhë. Edhe subjektet e tjera kanë ruajtur kuotën. Asnjë femër në krye të ndonjë drejtorie. Në Vushtrri nga 35 delegatë, 10 janë femra. Në KK të Shtimes janë gjithsej 7 këshilltare, kurse Arsimin dhe Kulturën në ekzekutivi i drejtojnë femrat. Në Rahavecin nga 31 anëtarë të KK-së 11 janë femra. Asnjë drejtoreshë në ekzekutiv. KK i Malishevës që ka 31 ulëse përbehet nga 11 femra. Vetëm një femër, Blerta Krasniqi, që e drejton Kulturën.

KK i Suharekës po ashtu me 31 ulëse i ka në përbërjen e vet 10 femra. Asnjë drejtori për femra. Lipjani i ka 10 femra nga 31 këshilltarë. PDK ka 3 këshilltare, LDK-ja 3 po ashtu, AAK-LDD 2, VV-1 dhe AKR-1.

Asnjë femër që e drejton ndonjë drejtori apo dikaster. Por, Kryesuesja është një femër – Vlora Limani – Hajnuni. KK i Kaçanikut i ka 27 anëtarë, femra janë 10. Asnjë udhëheqëse në ekzekutiv. Skenderajt prej 31 anëtarëve 9 janë femra. PDK-ja me 26 këshilltarë i ka vetëm 8 femra. Për herë të parë në ekzekutivin komunal është zgjedhur një femër drejtoreshë, në Drejtorinë e Administratës. Në KK të Vitës nga 27 këshilltarë 10 janë femra, kurse nga 10 drejtori i është femër. Dragashi ndërkaq, po ashtu, me 27 këshilltarë 9 femra i ka femra. Asnjë femër në drejtori. Në këtë komunë femra s’është e përfshirë asnjëherë. Graçanica e banuar me shumicë serbe, nga 17 këshilltarë, 8 i ka femra.

Kushtëzimi me virgjëri, shkelje e të drejtave të njeriut

Kjo ua ka imponuar femrave të kërkojnë “ndihmën” e mjekut për të rikthyer virgjërinë. Qepja e himenit madje po del të jenë bërë trend në Kosovë, pas luftës

Salie Gajtani

M.A. 22 vjeçare, nga Prishtina flet pa emocione rreth vlerës që mund të ketë virgjëri në një femre në kohët moderne.

“Shumë njerëz atë e konsiderojnë si diçka shumë të veçantë, një dhuratë për burrin. Por, unë mendoj se virgjëria nuk është asgjë, hiç asgjë”, thotë ajo.

Madje konsideron se një kërkesë e tillë nga mashkulli përbën shkelje të së drejtave të njeriut.

Ajo tregon se si kërkesa që me çdo kusht vajza të jetë virgjine, e kishte detyruar një shoqe të saj të kërkonte “ndihmën” e gjinekologut për ta rikthyer virgjërinë.

“Ia kërkonte i fejuari, si kusht për martesë dhe u detyrua ta qepte himenin”, thotë M.A.

Ajo thotë se këtë “shërbim” shoqja e saj e kishte marrë në një klinikë private, në afërsi të kryeqytetit, një natë vere. Për të kishte paguar 500 euro.

E rastet e qepjeve të himenit po del të jenë bërë trend në Kosovës, sidomos pas luftës. Edhe vetë gjinekologët dhe ekspertët e tjerë shëndetësorë e pohojnë këtë fakt, ndonëse me kusht anonimiteti. Ata madje, e pranojnë se për këtë “punë” klientet paguajnë edhe më shumë, deri në 700 euro.

“Këtë punë e bëjnë të gjithë gjinekologët. Më së shumti nëpër klinikat private, por bëhet edhe në Klinikën Gjinekologjike të QKUK-së, gjatë ndërrimeve të natës”, thotë një mjek i kësaj lëmie.

Raste të ralla për ekzaminim të virgjërisë në QKUK

Në QKUK nuk kanë dhënë asnjë përgjigje në pyetjet që u janë drejtuar në lidhje me këtë. Kurse, mjekët të klinikave private, duke kërkuar të mbesin anonim, e pranojnë një gjë të tillë.

E një dukuri tjetër shqetësuese po del të jetë fakti që vajzat detyrohen t'i drejtohen mjekut për ekzaminim nëse janë të virgjëra, ose jo.

Derisa në QKUK kanë deklaruar se rastet e tilla janë të rralla, drejtues të Mjekësisë Ligjore e thonë të kundërtën.

Kështu, Shpend Fazliu, zëdhënës në QKUK ka thënë se pas bisedës me u.d të drejtoreshës së Klinikës Gjinekologjike në QKUK, Myrvete Paçarada, krejt ajo që mund të thotë është se rastet e kërkesave për ekzaminime të virgjërisë janë të rralla.

“Rastet e tilla janë të rralla, ato kryesisht lidhen me dhunime, apo me maltretime të tjera, por Mjekësia Ligjore merret me to”, ka thënë Fazliu duke cituar drejtoreshën Paçarada.


Kurse, drejtori i Mjekësisë Ligjore, Arsim Gërxhaliu ka thënë se nuk janë të pakta rastet kur mjekëve u drejtohen palët për të vërtetuar virgjërinë e vajzave.

“Si Departament punojmë vetëm me urdhërese të Prokurorisë në raste se na kërkohet diçka e tillë. Më herët kemi bërë edhe me dëshirën e palës, por ka më shumë se një vit, që e kemi ndërprerë këtë praktikë, pasi kemi mësuar gjatë trajnimeve në vendet e perëndimit se atje nuk bëhet një e tillë, sepse kjo konsiderohet si ndërhyrje në integritetin personal”, ka thënë Gërxhaliu.

Ndryshe, ai ka pohuar se janë të shpeshta rastet kur prokuroria kërkon ekzaminime të virgjërisë.

“Ato janë raste të dhunës seksuale, dhe ndonjëherë kemi edhe raste të ekzaminimeve të cilat vijnë si pasojë e problemeve familjare dhe rasti kërkohet të sqarohet përmes institucioneve”, ka thënë Gërxhaliu.

Mirëpo, sipas tij, pa marrë parasysh se për çfarë rasti bëhet fjalë, në çdo variant ku kërkohet të bëhen ekzaminime të tilla, është e



Gjinekologët dhe ekspertët e tjerë shëndetësorë e pohojnë këtë fakt, ndonëse me kusht anonimiteti. Ata madje, e pranojnë se për këtë “punë” klientët paguajnë edhe më shumë, deri në 700 euro.

domosdoshme që të merret edhe pëlqimi i palës.

“Kemi edhe raste kur i fejuari apo ‘boyfriends’-i e sjellë të dashurën dhe kërkon që të bëhet ekzaminimi i virgjërisë së saj, sepse ka dëgjuar që ka femra që po e qepin cipën himenale”, ka thënë Gërxhaliu.

Pastaj ka shtuar se “kemi pasur edhe pasur raste kur edhe është zbuluar një gjë e tillë”.

Gërxhaliu e ka pranuar se rreth secilit rast që silltet për ekzaminim lëshohen edhe vërtetime rreth gjendjes së vajzës.

Ndryshe, ai si ekspertë i mjekësisë ligjore, thotë se nuk është himeni, apo disa pika gjaku ato që vërtetojnë saktësisht virgjërinë e femrës. Kjo, siç e sqaron ai, ndodhë pasi që ka jo pak raste kur femra është e virgjër, por trupi i saj është elastik dhe nuk jep shenja, të cilat në popull njihen si virgjëri.

“Jo, sepse kushtet e jetës sot, ushqimi artificial dhe shumë faktorë të tjerë që ndërliken me mënyrën e jetesës janë duke e rritur përqindjen e numrit të femrave, të cilat posedojnë, kanë të ashtuquajturin ‘himen elastik’ dhe e njëjta nuk shqyhet deri në lindje”, ka nënvizuar Gërxhaliu.

Ai ka shtuar se në kohët e mëherëshme, për këtë gjë janë bërë edhe edhe gjaja, ani që femra me të vërtetë ka qenë e pastër. Sipas tij, rezultatet mjekësore konsiderojnë se 30 për qind të femrave kanë

himen elastik.

E një mjek tjetër, i cili punon në një klinikë private në Prishtinë, ka treguar se “kemi raste kur i fejuari, e sjell të fejuarën për t’ia verifikuar virgjërinë para se të ketë kontakt intim me të, pastaj e kryen aktin dhe një ditë pas kësaj, ai sërish e sjell të fejuarën, apo të dashurën për ta kontrolluar me qëllim që të bindet nëse ia ka prishur virgjërinë ose jo”.

Pos, kësaj ia ka thënë se ka pasur edhe raste të tjera, dhe ato janë të shumta në numër, kur dhëndri e sjellë nusen për ekzaminim, pasi e ka kryer dasmën. “Raste të tilla, shpeshëherë na vijnë me shenja ku shihet se është ushtruar dhunë ndaj femrës”, ka thënë ky mjek.

Por, me këto probleme nuk pret se do të ballafaqohet B.E. 25 vjeçare, intelektuale nga Prishtina. Ajo ka thënë se nuk ka pasur asnjëherë kontakte intime me askënd dhe se kjo e bën të ndihet krenare.

“Pavarësisht që jam në prag të ditëlindjes së 25-të, dhe jetoj në një kohë kur të qenit e virgjër nuk e ka kuptimin që kishte në një tjetër kohë, për mua rëndësia e të qenit e virgjër nuk është zbehur asnjëherë”, ka thënë ajo.

Ndërsa, ka shtuar se nuk kam qenë asnjëherë e prirë të bie pre e komplekseve të kohës, e as të konsideroj se të qenit e virgjër është demode. Sipas saj, në ditët e sotme, në bazë të asaj që flitet në rrethin

shoqëror, një e virgjër nuk ka asnjë përparësi.

“Megjithatë, në një raport më intim dhe më të sinqertë do të thoja, që virgjëria ende e ruan një rol vendimtar në krijimin e një raport më serioz mes dy partnerëve, po flas për një raport që ndërtohet me dëshirën dhe tendencën për të krijuar martesë e familje”, ka thënë ajo.

B.E. pastaj shton se është e sigurtë se një martesë e lumtur nuk duhet të kushtëzohet nga virgjëriteti i gra, por megjithatë beson se për një mashkull shqiptar, virgjëria ende e ka një rol shumë të rëndësishëm. Këtë e pohon edhe N.Zeka, një i ri i cili shkon përditë për të kryer faljen në njërën nga xhamitë e kryeqytetit.

“Vajza për t’u bërë nuse e devotshme duhet të jetë e virgjër. Kjo, flet për pastërtinë e moralit të saj të cilin duhet ta ruajë tërë jetën”, thotë Zeka.

Ai thotë se nuk do të merrte kurrë për grua një vajzë që nuk është e virgjër. E pranon se këtë ndjenjë më shumë e ka ushqyer nga “rrethi i shokëve të xhamisë” sesa në familje.

“Jo, jo, në familje nuk kemi fol kurrë për këtë punë, është marre”, thotë ai duke qeshur.

Megjithatë, mbetet pa fjalë kur pyetet se si do të jetë i sigurtë se një që femër që hyn në martesë si e virgjër, nuk do të tradhëtoj kurrë. Ai thotë se “virgjëria dhe besnikëria janë kusht për femrën, njësoj sikurse jeta”.

Nuk e pranon se një gjë e tillë është shkelje e të drejtave të njeriut, apo diktat.

Kërkesa e pakuptimtë

Por, ndryshe nga ai mendon sociologu shumëvjeçar Shaip Hasani. Ai thotë se rymat e tilla, përmes të cilave është ushtruar diktat mbi femrën kanë

ekzistuar gjithmonë, por se tani kohët kanë ndryshuar.

Ai thotë se trendin e të jetuarit të lirë dhe në mënyrë të pavarur, e pa kushtëzime nuk mund ta ndalë askush.

“Kontaktet dhe komunikimi i hapur me botën është kthyer në sistem bashkëkohor, dhe ato i kanë hapur rrugë lirisë dhe përcaktimit kah trendet më moderne që sot bota dinamike i ka”, ka thënë Hasani.

Ai ka thënë se këto tende janë edhe pjesë e Kosovës

“Këto tende madje edhe dominojnë, dhe nuk ka kush t’i ndalë madje mendoj se mentaliteti, tradita, dhe shprehitë e së kaluarës sikur i kanë shtuar këto kërkesa. Ato dominojnë ndaj kërkesave dhe kushtëzimeve për virgjërinë”, ka thënë Hasani

Ai ka thënë më tutje se “kërkesat për virgjëri, si të tilla mendoj se ndoshta kanë pasur elemente pozitive, siç ka qenë ruajtja e shëndetit dhe pastërtisë, por se jeta bashkëkohore pa këto kushtëzime tashmë e ka marrë dheun dhe këto çështje nuk ka asnjë fije dyshimi, se mund të ndalen qoftë as edhe si kushtëzim”.

Ai shtë i bindur se kërkesa për kushtëzim rreth virgjërisë nuk është e përfillshme në këto kohë dhe as në ato që vijnë.

“Derisa jemi pjesë e një civilizimi që i bën njerëzit të barabartë, mendoj se kushtëzime e tilla janë të palejueshme, dhe nuk do të duhej të ndodhte kjo në ditët e sotme, aq më pak deri në atë shkallë sa të diktohet e ardhmja e njeriut, apo individit”, ka thënë Hasani.

Sipas tij, kushtëzime të tilla ka edhe tek besimet tjera fetare, jo vetëm tek ajo myslimane.

“Këto procese janë prezente edhe tek jahuditë, por edhe të tjerët. Tek disa, madje janë të ngulituara thellë dhe nuk ndryshojnë në skemën vertikale, ku kërkesat e janë të skajshme dhe madje përdoren edhe ndëshkime të rënda fizike ndaj femrat jo të virgjëra”, ka thënë sociologu me përvojë të gjatë në këtë lëmi.

E M.A. këmbëngul se virgjëria nuk e bën të lumtur një martesë.

“Ndoshta, virgjëriteti e bën të lumtur një martesë, por vetëm muajt e parë. Kur ajo gjë të harrohet, njeriu duhet të ketë diçka tjetër që ta mbajë të lumtur martesën. Virgjëriteti nuk është dashuri, nuk është respekt dhe sinqeritet”.

thotë M.A. Betohet se vetë nuk do ta bënte kurrë një hap për rikthimin e tij.

“Nuk do të isha qepur kurrë në jetë. Edhe nëse mashkulli i fundit që ekziston do të kishte kërkuar që të jem virgjine, nuk do e bëja”, thotë ajo. Ndërsa, shton se “nuk do ta bëja për vet faktin se dua që dikush të më dojë për këtë që jam, jo për një copë lekure në vagjinën time”.

E bindur se femra duhet të vlerësohet më tepër për të tjera gjëra, siç është shkollimi, përgatitja për në jetë dhe familje, kultura dhe edukata personale...A.M shton se “për mua personalisht, nuk ka asnjë lloj rëndësi çështja e të qenit e virgjër, ose jo”. Madje shton se këtë gjë as që lejon ta diskutojë mashkulli që pretendon të ketë një lidhje me të.

Ajo shton se kërkesa për të qenë e virgjër me çdo kusht, është një nga shkeljet më të mëdha të të drejtave të njeriut.

“Është diçka banale. Nuk duhet ta duash një person pse është e virgjër, ose jo, por duhet ta duash për atë që është në brendësi”, përfundon M.A.

Gratë larg “punëve të burrave”

Derisa shkalla e papunësisë në vend vazhdon të jetë shumë e lartë, më të prekurat nga papunësia janë gjinia femrore. Vërejtje për këtë Kosovës i është dhënë edhe në raportin e progresit. Ndërkohë në parlamentin e Kosovës janë bërë rekomandime që në ligjin për barazi gjinore kuota gjinore në punësim në institucione publike të rritet nga 30 në 50%

Majlinda Aliu

Mbijetesa nga varfëria e skajshme në vend, shumë kend e ka sprovuar me shumëcka. Por Valentina Shaqiri-Selaci nga Vushtrria është sfiduar dyfish. Lufta e fundit në Kosovë ia mori babanë dhe dy vëllezërit. Qysh në moshën 13 vjeçare, ajo u detyrua të marr siper rolin e kryefamiljares. Por bashkë me këtë barrë të madhe ajo u detyrua të marr edhe një barrë tjetër, të “konvertoj” vetën në mashkull.

“U bona si mashkull, e mora kalin dhe shkojsha në mal për të pre dru të cilat pastaj i shisja për ta nxjerr kafshatën e familjes. Pastaj kam vazhdu të punoj me karrocë në pazar. Më vonë kam punuar në një dyqan si shitëse” Valentina kujton këto momente të fëmijërisë së saj të hidhur, ndërsa sot ndjenë mungesën e vajzërisë që do duhej ta përjetonte dikur.

Duke të kujtuar personazhin famëshëm Nita të Josip Reles, ajo ngriti kureshtje edhe të publikut. Kur u prezantua për herë të parë në emisionin “Anima” në KTV të autores Vjosa Abazi, Valentina befasoi shumë kend për kurajon që kishte pasur. Pas kësaj, shumëkush i ofroj asaj ndihmë dhe jeta e saj filloj të marr një tjetër kuptim. Ajo sot është një femër elegante, ndonëse në karakterin e saj ende kanë mbetur shprehje mashkullore. Nevoja për tu kthyer në gjininë e saj biologjike, i kishte ardhur kur ajo u dashurua në bashkëshortin e saj Artanin.

Ajo thotë se ka pasur shumë paragjykim nga rrethi i njerëzve kur bënte punë fizike, e që shquhen si punë burrash. Derisa ndëzë një cigare ajo tregon për nënçmimet që i janë bërë. “Më kanë thanë qysh s’po të vjen marre me bo këtë punë. Unë nuk mendoj që është marre me bo një punë fizike, kur e bon me nderë. Cdo femër mundet me bo punë, qoftë taksiste, shofere autobusi, kamariere apo cila do coftë ajo.” E për këtë të duhet vetëbesim thotë ajo.

Duke mos pasur më “privilegjin” e petkut mashkullor, Valentina kur mori sipër për të udhëhequr një biznes të vogël, nga shumëkush u pa me dyshim që po të mos ishte bashkëshorti i saj Artani, ajo sdo të ecte përpara.


“Kam fillu me biznes të vogël, kam pas 10 punëtore për t’i menaxhuar, dhe skam pas fare problem. Por nuk përkrahesh si grua madje edhe nga vetë gratë kur dëshiron me zhvillu biznes që kishte me punësuar femrat”. Ajo thotë se ka kërkuar mbështetje nga organizatat e grave që veprojnë në Kosovë, por nuk ka gjetur gatishmëri për mbështetje. Ideja e saj është që në biznesin e saj të punësoj vetëm femra.

Paragjykimet

Derisa Valentina, e cila është nga një zonë provincialiste dhe është paragjykuar që po bënë “punë të burrave”, më lehtë nga paragjykimet nuk ka kaluar as Oda Haliti, e cila si femër ambicioze qysh në moshë 23 vjeçare ka vendosur të hap biznesin e saj.

Para 4 vitësh, kur ajo kishte vendosur të hap lokalin e njohur në kryeqytet “Gegë”, pengesën e parë e kishte hasur tek pronari i lokalit, të cilin ajo e cilëson si tip fanatik.

“Pasi u mora vesh me marr lokalin, pronari i lokalit ka negociuar me ia dhënë lokalin dikujt tjetër, me që ka thënë se kjo është femër dhe ma lëshon lokalin. Nuk mujsha me besu që spo don me ma dhonë lokalin, veç se jam femër” shton ajo. Asaj i është dashur të prezantoj të atin si “garantues” që të mund të vazhdoj me biznesin e saj. Pengesat nga paragjykimet Odes nuk i mbarojnë me kaq. Ajo edhe përkundër dështësive që në lokalin e saj të punësoj vetëm femra, nuk ia doli që këtë “barrier” ta thej lehtë. “Unë fillimisht kur e kam hap lokalin kam dashur që gjithë shërbimi të bëhet prej femrave,



Anëtarja e Komisionit Parlamentar për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore Rita Hajzeraj, thotë se një nga rekomandimet në ligjin për barazi gjinore është që kuota gjinore të ngritet nga 30% në 50% duke e pasur parasysh ende mentalitetin patriarkal në Kosovë

edhe dojsha me thy atë idenë që gjithmonë shërbimi ofrohet prej meshkujve. Unë mendoj që femrat janë shumë të mira në hotileri, me që janë detajiste. Por me që nuk mujta me gjet femra që duan me punu, vazhdova me punëtorë meshkuj”

Më vonë ajo pati hapur një lokal tjetër nate, të njohur si “Shallter” ku ajo nuk ka gjetur pengesa të zhvilloj biznesin e saj. Me lëvizjet nga njëri biznes në tjetrin, Oda thotë se e sfidon vetën, ndërsa pengesat dhe paragjykimet vetëm e irritojnë por nuk e stopojnë për të bërë punën që don.

“Së fundmi kam pas ballafaqim me një kamarier, i cili nuk mujke me pranë kritikën prej një femre. Poashtu policia kur vijnë, kur dikush ankohet prej zhurmes gjithmonë e lypin shefin. Kur unë përballëm me ta, ata kërkojnë shefin. Kur ju them: unë jam shefi, thonë: ok, thirrë partnerin, sepse nuk mujnë me pranë me u ballafaqu me një femër, me që kanë qasje maskuliste”.

Por sfidat e paragjykimëve gjinore për Oden nuk përfundojnë as këtu. Para një kohe kur ajo kishte shkuar në ATK për t’u ankuar për një denim të lartë që i kishin shqiptuar, disa nga zyrtarët e këtij instiucioni i kishin

thënë “Hajt se ta paguan burri” ajo ishte irrituar. “Kjo ka qenë dëshpruese, një muaj skam mujt me ardh në vete, smujsha me u pajtu me këtë realitet”.

A po shkojmë në regres

Autorja e emisionit të KTV-së “Anima” që u dedikohet grave, Vjosa Abazi, kujton që në vitet e para të punës, me lehtë ka gjetur femra që kanë bërë “punë burrash”, ndërsa sot ajo thotë se ato janë martuar dhe puna e tyre ka mbaruar aty.

“Femrat të cilat bëjnë punë, që shquhen si punë të meshkujve kanë qenë kryesisht raste që kam intervistuar në vitet 2002-2008. Kam intervistuar, taksiste, zdrukthëtare, elektriciste, auto-mekanike e shumë profesione të tjera. Por sot ato femra më nuk i kryejnë këto punë. Shumë prej tyre vështirë i kam bindur të flasin para kameras, me që vendi ynë ka paragjykimë, dhe s’kanë dashur që puna e tyre të bëhet publike” tregon Abazi. “Sot, 14 vjet pas lufte, unë mendoj që kemi pasur regres, sa i përket angazhimit të femrave në punë, vlerëson autorja e emisionit “Anima”.

Për antropologjen Nita Luci, vitet

90’ kanë prodhuar këtë ndarje gjinore, kur edhe kanë filluar të strukturohet ideja e shtetit komb. “Kombi si strukturë është patriarkal, me që burrat gjithmonë në idenë narrative janë luftëtarë, shkrimtarë, politikan ndërsa gratë në anën tjetër janë nëna”.

Para 20 vitësh prezenca e femrave në hapësira pulike ka qenë e kufizuar dhe tek ne është risi që gratë mund të pushtojnë hapësirën publike. “Arsyeja pse tek ne femrat nuk bëjnë disa punë, është sepse ne i moralizojë, duke i vlerësuar si punë me ndjeshmëri për femra. Ndërsa thelbi gjithë kësaj është edukimi i burrave tanë” vlerëson Luci.

Sipas saj, pushteti i ri për ta deligjitimuar pushtetin e më herëshëm, thotë se ne po shkojmë përpara dhe krijon një iluzion të pa qëndrueshëm të emancipimit të femrës. Ndonëse kuoten gjinore e sheh si mundësi të mirë për avancimin e gruas në politikë.

Baza ligjore

Kosova ka bazë ligjore, e cila rregullon pozicionin e femrës në shoqëri, sic janë ligji për barazi gjinore dhe ligji kundër diskriminimit,

megjithë këto ligje nuk po gjejnë zbatueshmëri në terren madje as 50% dhe si rrjedhojë janë sjell në kuvend për plotësim-ndryshim.

Anëtarja e Komisionit Parlamentar për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore Rita Hajzeraj, thotë se një nga rekomandimet në ligjin për barazi gjinore është që kuota gjinore të ngritet nga 30% në 50% duke e pasur parasysh mentalitetin patriarkal në Kosovë. “Kjo gjë duhet të hyje në ligj dhe kështu në konkurset për punësim në pozita udhëheqëse, gratë të kenë mundësi dhe qasjes të barabartë me burra “. Ajo shton se ekipi monitorues i këtij ligji në terren kanë vërejtur se nëpër komuna ngritja e femrave në pozita udhëheqëse është shumë e ulët. Andaj edhe është ardhur deri te nevoja e ndryshimeve ligjore, thotë ajo. Por se a do të marrin dritën jeshile këto ligje nuk dihet, me që sipas agjendës së kuvendit ato është paraparë të procedohen për aprovim në sesionin vjeshtor. Hajzeraj shfaq shqetësimin që këto ligje do të mbesin të pa ndryshuara, me që sic dihet Kosova ka hyrë në vit zgjedhor.

Problemor në zbatim mbetet edhe ligji i punës, i cili poashtu gjendet në parlament për amandamentim dhe diskutabil është pikërisht neni që ka të bëjë me pushimin e lehonisë.

Antropologja Nita Luci thotë se me aprovimin e këtij ligji, grave u është vështirësuar punësimi, e në rastet më të këqija kanë humbur edhe punën. “Kompanitë private askush nuk po i kontrollon dhe këto kompani më pak punësojnë gra se sa burra, sepse duan t’i ikun kompanizimeve për pushimin e lehonisë. Kjo e shkel ligjin kundër diskriminimit, andaj duhet përndjekje më e madhe ligjore”.

Sipas Bankës Botërore, treguesit e tregut të punës në Kosovë janë ndërrë më të këqinjë në rajon dhe gratë janë ndërrë grupet më të pafavorizuara. Vetëm 12% e grave janë të punësuar, në krahasim 34% të burrave në moshë pune.

Në Universitetin e Prishtinës, në vitin e parë kur regjistroheshin studentët, përfaqësimi gjinor është 50/50, për as gjysma e femrave të regjistruara nuk arrijnë cakun e diplomimit, thohet në një hulumtim të bërë nga komiteti për ekonomi i programit Hope Fellowship. Ky hulumtim gjithashtu konstaton se në kontekstin e Kosovës, përveç pengesave sa i përket hendekut arsimor midis grave dhe burrave të brezit të vjetër, gratë e reja janë të dekurajuar t’i bashkohen forcës së punës nga një sërë faktorësh institucionel dhe kulturor, sic është ekzistenca e normës kulturore ku vendimmarrja është e dominuar nga meshkujt.

Hulumtimi gjithashtu vlerëson se një prej elementeve kryesore që ndikon në fuqizimin e gruas është çasja në trashëgimi dhe ndarja e barabartë e trashëgimisë. “Në realitetin kosovarë, shpeshherë gratë heqin dorë nga trashëgimia për shkak të presioneve shoqërore, sic është ruajtja e harmonisë familjare ose shmangia e konfliktit. Në shumë raste meshkujt trashëgimtarë, kur bëjnë trashëgiminë e pasurisë, nuk i lajmërojnë fare në gjykatë motrat” thuhet në hulumtim.

Mungesa e pronësisë në duart e grave, mungesa e burimeve financiare dhe mungesa e mbështetjes së qeverisë janë faktorë të rëndësishëm që pengojnë zhvillimin e sipërmarrjes më të theksuar tek gratë, thuhet në Platëformën Kombëtare të Grave sipërmarrëse.

Derisa gjendja socio-ekonomike në vend mbetet në nivel të ulët, Valentina jep një mesazh për të gjithë gratë e Kosovës: “Mos u frikësoni nga sfidat, bëni punët që ju doni pavarësisht paragjykimëve të njerëzve me që ato gjithmonë të ekzistojnë”.

ÇIFTET KOSOVARE PRE E TRADITAVE PATRIARKALE

Mentaliteti i “derës së huaj”, nxitë aborte selektive

Blerta Aliu

N.N (35) nga Prishtina, asnjëherë nuk e kishte menduar se lindja e një djali mund t'i shndërrohej në qëllim jetësor. Këtë e kishte kuptuar vetëm pas lindjes së dy vajzave.


Se një djalë është i rëndësishëm për familjen, kishte qenë fakt i padiskutueshëm për bashkëshortin dhe vjehrrit e saj. Mbase edhe ajo mendonte njëjtë, por jo deri në atë masë sa të merrte vendime të dhimbshme por edhe të kundërligjshme për të arritur deri tek një djalë.

Tensioni në shtëpinë e saj po rritej pas lindjes së vajzës së dytë dhe në momentin kur u kuptua se po priste një vajzë të tretë, “ishite e patolerueshme” për bashkëshortin e familjen. Ndonëse një femër e shkolluar, 35 vjeçarja nga Prishtina thotë se s'mundi t'i bënte ballë presionit. “E abortova fëmijën e tretë vetëm pse ishte vajzë”, ka treguar ajo.

Që nga lindja e vajzës së dytë, N.N rrëfen se raportet bashkëshortore kishin filluar të acaroheshin. Madje ishte arritur një dakordim mes çiftit që shtatzënia e tretë do të tolerohet vetëm nëse bëhet fjalë për djalë. Por ajo nuk e kishte besuar se vërtetë do të ndodhte ndërprerja. Ndoshta më tepër kishte besuar se shtatzënia e tretë do t'i sillte një djalë pa pasur nevojë t'i nënshtrohej një aborti selektiv. “Nga java 11 e shtatzënisë së tertë e deri tek java e 13, tri here kemi bërë kontrolle për të verifikuar gjininë, dhe kur mjeku ka qenë shumë i sigurt se bëhet fjalë për vajzë, atëherë e kemi caktuar terminin në një klinikë private në Prishtinë. E kam hequr fëmijën. Trajtimi ka qenë i mirë por procesi shumë i vështirë”, ka shpjeguar ajo. Tërë këtë thotë ta ketë bërë për hir të rregullimit të raporteve me burrin dhe familjen e tij. Pas këtij procesi në shtatzëninë e katërt ajo kishte sjellë në jetë një djalë.

Megjithatë nuk ndihet e përbushur për shkak të së kaluarës. Shtatzënia e tretë vazhdon ta trazojë ende atë si nënë. Madje ka treguar se veprime si të saj, kanë ndërmarr e po ndërmarrin edhe shumë gra tjera në Kosovë. Thotë të jetë çështje e mentalitetit mashkullor që ende mbizotëron në Kosovë. Se femrat kosovare po bëjnë ndërprerje të shtatzënisë me motiv të përzgjedhjes së gjinisë së frytit, nuk e mohan askush. Megjithatë nuk ka të dhëna të sakta për një gjë të tillë pasi që aborti selektiv i gjinisë, është i ndaluar me ligj.

Gjinekologët më me përvojë në vend, pohojnë se mjekësia e egër që po zhvillohet në shumicën e institucioneve shëndetësore private si dhe mungesa e etikës profesionale, po bënë që një numër i madh i mjekëve të kryejnë edhe veprime të tilla të paligjshme. Në kushte anonimiteti një gjinekolog brenda QKUK-së, ka treguar se kolegët e tij “për para po bëjnë çdo gjë”, përfshirë edhe abortin selektiv. Duke mos dashur të përmend emra ka bërë të ditur se, “ky krim bëhet në shumë ordinanca e klinika private në Kosovë pasi që ka kërkesa për aborte të tilla. Këto janë shërbime të paevidentuara që nuk mund të dihen se sa janë në numër. Çmimi për një shërbim të tillë po ashtu është i pacaktuar. Në shumicën e herëve nuk mund të jetë nën 200 euro. Kjo varet krejt nga xhepi i klientit”, ka treguar ai. Sipas këtij burimi, femrat duke dashur të arrijnë deri tek lindja e një djali, kohëve të fundit kanë filluar të nxisin aborte në rastet kur kanë vajza, edhe përmes përdorimit të tabletave të ndryshme të cilat i marrin nëpër barnatore pa receta mjekësore. “Këtu kemi të bëjmë me problem dhe ndërjegje të ulët edhe nga ana e farmacistëve që japin bari pa receta. Disa tableta të quajtura ‘Citotek’ po përdoren më së shumti



kohëve të fundit për të nxitur aborte të tilla”, ka sqaruar ai. Ndërkaq thotë se nxitjet e tilla e rrezikojnë seriozisht shëndetin e nënës. Por deri tek këto vendime pohon se i shpjen mentaliteti patriarkal si dhe mungesa e vetëdijesimit lidhur me rreziqet e aborteve.

Myrvete Pacarada, drejtoresh e Klinikës së Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ka thënë se abortet selektive nuk bëhen në klinikën që ajo drejton. “Ato janë rreptësisht të ndaluara me ligj”, ka thënë ajo.

Megjithatë nuk e ka përjashtuar mundësinë se ka gjinekolog “të pandershëm” që kryejnë intervenime të tilla nëpër klinika private. “Kjo është problematikë edhe e shteteve tjera përreth si: Shqipëria e Maqedonia ku bëhen gjëra të tilla. Seleksionimi i gjinisë nuk do të duhej të bëhej askund dhe ish dashur të dënohen të gjithë ata që e bëjnë. Nuk është aspak njerëzore të bëhet diçka e tillë dhe unë nuk pajtohem as si profesioniste dhe as si femër me këto aborte”, ka thënë ajo.

Abortin selektiv ajo nuk e sheh si “diçka sporadike” që po ndodh në Kosovë. “Nuk është shumë i theksuar, unë nuk kam vërejtur diçka të tillë dhe nuk e di se kush i kryen këto. Vetëm se e kam me të dëgjuar. Po ta dija se e kryen dikush do ta lajmëroja, apo po të vinte dikush në klinikë pas komplikimeve në një or-

dinancë private gjatë një aborti të tillë unë do ta lajmëroja”, ka thënë ajo.

Kurse Faik Hoti, zëdhënës i Ministrisë së Shëndetësisë ka treguar se çështja e ndërprerjes së shtatzënisë është e rregulluar me Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë. Ky ligj sipas tij përcakton bazën ligjore për rregullimin e ndërprerjes së shtatzënisë, me qëllim të marrjes së të gjitha masave mbrojtëse për të larguar femrën nga rreziku i rritjes së morbiditetit dhe mortalitetit të saj si pasojë e bërjes së aborteve ilegale. “Sipas Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, çdo femër e moshës mbi 18 vjeç ka të drejtë që të kërkojë ndërprerjen selektive të shtatzënisë. Gjithashtu, femrat që kanë aritur moshën e rritur prej 16 vjetësh dhe kanë marrë pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen e shtatzënisë”, ka thënë ai. Hoti ka bërë të ditur se ndërprerja e elektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së dhjetë të shtatzënisë.

Ndërkaq çdo ndërprerje e shtatzënisë pas javës së dhjetë duhet të bëhet me komision shëndetësor profesional dhe mund të bëhet për arsye mjekësore në rastet ku konstatohet se vazhdimi i shtatzënisë, ose lindja e fëmijës rrezikon jetën ose shëndetin e femrës.

“Inspektorati ka sanksionuar në disa raste institucionet dhe profe-

sionistë shëndetësor të cilat kanë kryer procedura të ndërprerjes së shtatzënisë në kundërshtim me ligjin”, ka thënë ai.

Sa i përket ndërprerjes së shtatzënisë me motiv të përzgjedhjes së gjinisë së frytit, Hoti thotë se është rreptësisht e ndaluar dhe se mungojnë të dhëna për raste të tilla. “Institucionet, edhe kur i raportojnë rastet e aborteve, ato i raportojnë si aborte selektive apo me indikacione mjekësore”, ka thënë ai. Sipas Hotit, nuk është evidentuar asnjë rast që lidhet me abort selektiv të gjinisë. Më tej ka bërë të ditur se sipas të dhënave nga Klinika Gjinekologjike Obstetrike e QKUK-së, gjatë vitit 2013 ka pasur: 338 aborte spontane, 676 aborte të indukuara dhe 123 aborte artificiale (kur nxitet aborti në mënyrë të qëllimshme me barna apo procedura klinike).

Ndërkaq sociologja, Linda Gusia, abortin selektiv në të cilin e pësojnë në shumicën e rasteve frytet-vajza, e sheh si një element që e shpjegon patriarkalitetin që mbizotëron në shoqërinë kosovare. “Tek ne mungojnë të dhënat statistikore pasi që abortet e tilla kryhen nëpër klinika private. Është një abort ilegal pasi që mund të ndodh vetëm pas muajit të tretë të shtatzënisë atëherë kur shihet gjinia e fëmijës”, ka thënë ajo.

Se preferencat e çifteve kosovare anojnë nga djemtë, thotë se vërehet edhe nga mënyra se si ndahet

Sipas të dhënave nga Klinika Gjinekologjike Obstetrike e QKUK-së, gjatë vitit 2013 ka pasur: 338 aborte spontane, 676 aborte të indukuara dhe 123 aborte artificiale (kur nxitet aborti në mënyrë të qëllimshme me barna apo procedura klinike)

prona, emri etj. Një familje që nuk ka djalë, thotë se ende konsiderohet si e rrezikuar.

“Diskriminimi i vajzave nuk ndodh vetëm tek abortimi. Në përgjithësi kujdesi ndaj vajzave është më i vogël. Vlerësimi për vajza është më i ulët qysh prej ditës kur lindin dhe kjo më pas i përcjell gjatë tërë jetës. Ende vajza shihet si ‘derë e huaj’. Jemi një shoqëri seksiste...”, ka shtuar Gusia.

Këtë e ka mbështetur edhe me përfaqësimin jo të denjë të femrës nëpër institucione.

“Duhet të ndërrohet dhe të tejkalohet ky mentalitet patriarkal dhe seksit. Kjo mund të bëhet vetëm me emancipimin e grave. Por edhe prindërit duhet të vetëdijesohen që ti duan dhe t'i fuqizojnë sa më shumë vajzat”, ka vlerësuar ajo.

Kurse një raport i publikuar në dhjetor të 2013-s nga Instituti kombëtar i studimeve demografike (INED) në Francë për të cilin kanë raportuar mediat ndërkombëtare, flet për një disproporcion të madh mes numrit të vajzave dhe djemve të lindur në disa shtete të Azisë dhe të Ballkanit Perëndimor. Aty thuhet se në këto vende shkalla e gjinisë ka rritur ndërmjet 110 - 117 djem në 100 vajza. Sa i përket Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi, thuhet se shkalla është më pak e theksuar, pasi ajo ka arritur nivelin 110-111 djem në 100 vajza.

Feminizmi si ndryshim

Feminizmi ka filluar si synim për ndryshim, por me kohë ka ndryshuar edhe vetë



Luljeta Demolli

Që prej grave të guximshme të lëvizjes Suffragette, e deri te pjesëmarrëset e të tria valëve, feminizmi ka pasur shumë ndryshime. Por, thelbësisht, ka mbetur i njëjtë: barabarësi e të drejtave, fuqizim, dhe rritje e mirëqenies në jetët e grave në mbarë botën.

Pamundësia objektive që lëvizjet feministe t'i adresojnë në plotësi të gjitha kërkesat e grave ka bërë që brenda ombrellës gjithëpërfshirëse të feminizmit të krijohen edhe disa "nën-lëvizje", të cilat fokusohen në çështje më të veçanta.

Një rast të këtillë paraqesin Feministet e Reja.

Kjo nën-lëvizje ndihmon që një segment i caktuar shoqëror, siç janë gratë e reja feministe, të shndërrohet në subjekt të rëndësishëm diskursiv dhe të analizohet më veçanërisht në kompleksitetin e vet. Pra, të fitojë një autonomi brenda fushës së gjerë të feminizmit.

Një qasje e tillë është shumë e dobishme sepse krijon mundësi më të mëdha për identifikimin më preciz të kërkesave dhe gjetjen e zgjidhjeve të problematikave specifike.

Edhe gjatë disa dekadave të Lëvizjes së Grave në Kosovë, feministet e reja kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm. Ato kanë qenë dhe janë pjesë përbërëse e organizimit të saj.

Një akt që ndodhi disa javë më parë ndikoi në ringjalljen e debatit për mundësitë e reja dhe ridefinimin e vlerave që e orientojnë të menduarit tonë të feminizmit.

Pas sulmit që iu bë revistës Kosovo 2.0, në promovimin e numrit për seksin, më 14 dhjetor 2012, ishte e vështirë të parashikohej organizimi i ndonjë ngjarjeje tjetër publike që do t'i trajtonte hapur çështjet LGBT.

Ndodhi e kundërta.

Në ditën e Shën Valentinit të sivjetmë, grupi performues "Haveit" bëri fotografi në Sheshin Nënë Tereza të Prishtinës, derisa katër anëtarët e saj putheshin në buzë me njëra-tjetrën.

Legjenda e fotografisë ishte një referencë e drejtpërdrejtë për mostolerancën ndaj komunitetit LGBT në Kosovë: "Në këtë të ashtuquajtur 'Ditë të Dashurisë', kjo shoqëri akoma refuzon dhe ndalon dashurinë e të njëjtës gjini për arsye 'moralit'. Dashuria le të mbizotërojë!".

Realizimi i një performanse të tillë në këtë ditë ishte veprim unik dhe rezultoi me risjelljen në debat të çështjes së të drejtave të këtij komuniteti. Të rejtat e "Haveit" treguan origjinalitet dhe guxim në mënyrën e dhënies së mesazhit, gjë që rezultoi me prezencë në media dhe në rrjetet sociale.

Performansa e tyre u pëlqye dhe u mirëprit edhe në qarqet e ndryshme feministe kosovare.

Gratë e reja në Kosovë edhe sot ballafaqohen me paragjykimet dhe sfida që u përngajnë atyre me të cilat janë përballur gjeneratat e mëparshme.

Ende nuk mund të thuhet se janë tejkuluar kualitativisht stereotipet dhe kufizimet në punë, në arsim dhe në jetën familjare.

Barazia e mirëfilltë kërkon ndryshime të perceptimeve dhe qëndrimeve, e jo vetëm të ligjeve, siç ndodh zakonisht te ne.

Feminizmi në Kosovë do të ishte edhe më i popullarizuar në mesin grave të reja në qoftë se atyre do t'u krijoheshin më shumë mundësi për veprime dhe shprehje të kreativitetit dhe individualitetit.


Do të ishte gabim i madh nëse potencialet intelektuale dhe kreative të të rejave kosovare të mos inkorporoheshin denjësisht në strategjitë dhe planifikimet afatgjata gjinore.

Prandaj, organizatat që punojnë për çështjet e të drejtave të grave e kanë për obligim t'i përkrahin shumë më tepër feministet e reja, ngase rritja e kontributit të tyre do të kishte efekte regjeneruese në të gjitha sferat e funksionimit të Lëvizjes Feministe.

Fuqizimi i grave kosovare mund të bëhet vetëm me gjithëpërfshirje.

Që i nënkupton edhe vetë feministet.

(Autorja është menaxhere në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore)



UNISEX

Çuditem, pra jam

Transformimi nga "pyetjet" në "çudi" do të ishte rruga e vetme që do të ndryshonte qasjen, ndoshta edhe të vet gruas mbi veten e për të mos thënë edhe të shoqërisë ndaj saj. Andaj, çudituni, për të mos thënë indinjohuni! Sepse vetëm duke u çuditur mund të deshifrohet mesazhi i reklamës së një salloni ondulimi me formulimin "bëje burrin për vete – rregullohu në ..." Derisa nuk kuptohet se bukuria është liri, e jo robëri që mund të pushtojë dhe të pushtohet, ne do mbetemi duke shtruar pyetje, prandaj çudituni!



Sibel Halimi

Makina kërkuese "Google" duket të mos jetë sofistikuar deri në atë masë, sa që të vërrë në dispozicion shumë opsione kur klikohet emërtimi "gruaja". Vjega e parë që të çon të gruaja në "Google" është një tekst gjysmak në "Wikipedia" me informacione stereotipe. Aty gruaja paraqitet si krijesë njerëzore që lufton për të drejta ose për ndryshime kulturore në shoqëri. Për më tepër, ajo portretizohet si një ndikuese e drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe përparimin e gjinisë njerëzore, sepse ajo ka kontakt shumë me të afërt me fëmijët.

Kësisoj, "Google" është dritarja reale e prezantimit të pozitës në të cilën gjendet gruaja në trevat shqiptare. Madje, nuk është aspak e rastësishme që shumë klikime në "Google" të dërgojnë në vjega religioze, ku gruaja jo që trajtohet, por satanizohet. Por, subjekti grua është gjithashtu edhe mjet përdorimi nga organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat në ngarendje për ta afirmuar rolin e gruas, e rrënojnë atë.

Një situatë të tillë nuk e kemi me të shkruar nocionin "femra". Tani paraqitja e çështjeve që lidhen me "femra" ka të bëjë kryesisht me të qenit e bukur që nuk lidhet domosdoshmërisht me ndonjë person të caktuar apo ndonjë përgjegjësi të caktuar sociale, por në këtë stad, bukuria e saj, moda si dhe personazhet ek-

stravagante janë kryesisht portreti me të cilin ravijëzohet "femra" në "Google", e paraqitur kryesisht në portale, të cilat përdorin një gjuhë seksiste.

Në fakt, të dy nocionet "grua" dhe "femër", paraqesin pikërisht qëndrimin ndaj saj, pozitës së të qenit fillimisht femër e më pas grua dhe i cili nuk del të jetë i rastësishëm. Femra, që nënkupton investimin në aparencën e saj më pas e transformuar në "grua", jo më dukja si primat i ndërtimit të saj, por roli i të qenit grua, nënkupton krijimin e familjes.

"Gruaja" dhe "femra" në të dyja rastet tani janë atakuar nga shumë përpjekje, të cilat nëpërmjet reklamave e duan të bukurën përrallore e deri te nëna ideale. Në këtë kontekst, në shoqëritë triviale duke përfshirë edhe atë kosovare, modeli i përcaktimit të gruas dhe femrës përbën problematikën kryesore, në të cilën është vështirë të përcaktohet se çfarë në të vërtetë kërkon shoqëria jonë nga ajo.

Modeli grua, sot mbetet një model kontrovers, të cilin kushdo që dëshiron të ndërtojë ndonjë ideologji të caktuar, e bën pre, pa e menduar dhe kuptuar se cili është modeli grua konform vlerave kulturore të shoqërisë kosovare.

Prandaj, nuk është e rëndësishme se çfarë përmban "Google" për "grua" dhe "femër", por e rëndësishme është tendenca për ta përcaktuar se çfarë është "femra". A ndryshon të qenit "grua" në pozitë të përcaktuar, e rafinuar si aparencë apo përcaktim strikt i rolit të saj për vazhdimësinë e llojit njeri.

Habia është veti e njeriut, dhe përbën bazën e njohjes. Atëherë, një çudi gjinore sigurisht që do të duhej të shkruhej. Kështu ndodhi me

emërimin e menaxheres në kompaninë "Apple" pas vdekjes së Stiv Jobs. Lajm përbën fakti se kompania do të udhëhiqet nga një grua, e tek në pasusin e dytë bëhet i ditur emri i saj. Megjithatë kjo kompani dhe themeluesi i saj bën që jeta në glob të ndryshojë dukshëm në planin teknologjik, ajo nuk arriti ta eliminojë dallimin gjinor.

Identiteti social (gjinisë - gender) identifikohet pas sexit (mashkull - femër). E lajmi bëhet sensibilizues vetëm kur një grua do të jetë në krye të kompanisë, ndaj kjo tregon se polemika e thellë filozofike në mes gjinisë dhe seksit qoftë edhe në kontekste të tilla shoqërore dhe kulturore, vazhdon. Pra, kjo ka bërë që të mos çuditemi dhe subjektin femra apo grua ta shohim në kontekste shumë të kufizuara, jo përtej përshkrimit gjuhësor.

Ndaj logjikisht shtrohet pyetja çfarë në të vërtetë është "gruaja" dhe "femra"? Apo, ndoshta, pikërisht pyetja e tillë i jep hapësirë që secili ta projektojë modelin se si do dëshiron të shohë "femrën" apo "gruan". Pra, mbetet të mos përshkruhet subjekti apo çështja "grua" dhe "femër" në përgjigjet, por të ndryshojmë kahen e problematikës jo duke bërë pyetje a konkluzione, por duke shfaqur çudi. Thjesht ngaqë çudia është epistemologjia e vetme e cila na përballë me vetveten, në mënyrë që stadi i barazisë më të mos kuptohet vetëm si gjithëpërfshirje (mainstreaming) apo leksion politik. E, gruaja, a femra në këtë mënyrë shndërrohet në një selfie, ngase dilemat për të ngatërrohen në lidhëza të ndryshme ideologjike e pushtese. Kështu që ndodh modifikimi i maksimës së filozofes Simone De Beauvoir: "Ne nuk jemi gra, ne bëhemi të tilla" në "Ne jemi gra,

sepse çuditemi". Ky transformim duket rruga e vetme për ta ndryshuar qasjen edhe të vet gruas për veten, për të mos thënë shoqërisë në përgjithësi. Prandaj çudituni, në fakt indinjohuni, ngase në këtë mënyrë do të mund të kuptohet mesazhi i një salloni ondulimi "bëje burrin për vete – rregullohu...". Kjo lë të kuptohet se bukuria mund të jetë liri e pushtet për të mos e bërë burrin për vete, prandaj çudituni!

Nga perspektiva e Elizabeth Grosz, lidhshmëria ndërmjet nocionit "femër" dhe "grua" është e ngushtë, madje e pandashme. Ajo këmbëngul për specifikat e pakalueshme të trupit të gruas. Natyra themelore për Grosz është e lidhur me procesin e riprodhimit, edhe pse ajo pranon se këto mënyra apo përvoja nuk janë universale. Dallimi i tillë, sipas saj nuk jep identitet seksual që përcakton mënyrën në të cilën gratë i përjetojnë trupat e tyre, por do të jenë historikisht të ndryshueshme dhe shoqërore.

Prandaj, nuk është e rastësishme që feministet e para e kanë vrojtuar me dyshim trupin, duke shpërfaqur më shumë kompetencat racionale të mendjes femërore, e cila sipas Francois Poullain de la Barre "nuk ka seks".

Pikërisht, rrethanat shoqërore janë arsye shtesë për feministet e para të tilla si Wollstonecraft dhe Harriet Taylor Mill, të cilat e konsideronin me hamendje trupin.

Sistemi tradicional i vlerave nuk ka arritur të çlirohet nga kjo praktikë, e cila legjitimohet në forma të ndryshme, madje edhe nga vetë shteti.

Fenomeni i virgjërisë, ndikimi mbi kontrollin e lindjeve dhe parapërcaktimi i gjinisë së fëmijës, mund të jenë vetëm fazat fillestare të këtij kontrolli.

Në këtë kontekst shoqëror, nuk është i rastësishëm diskursi në Parlamentin e Kosovës kur u debatua përfshirja e grave të dhunuara gjatë luftës në Ligjin e veteranëve. Aty u propozua ekzaminimi i trupit, si mënyrë vërtetësie, mjet identifikimi nëse gratë janë të dhunuara apo jo. Kjo tregon qasjen e shoqërisë në përgjithësi ndaj trupit të femrës, ndaj është për t'u çuditur. Në Kosovë qepet himeni, një trend i rritur që kryhet nga shumë ordianca private, ndaj çudituni. Kjo s'është asgjë më shumë sesa një institucionalizim i krimin, ndaj çudituni!

Ka edhe më. Nëpërmjet shtetit, respektivisht nenit 16 të Ligjit të familjes një martesë mund të realizohet në moshën 16-vjeçare në rast se ekziston një kërkesë nga ana e kujdestarit të fëmijës. Pas konsultimit me mjekë që organizohet nga qendra sociale, vajza mund të martohet. Kjo praktikë nuk shihet vetëm si çështje kulturore, tradicionale, por edhe shtetërore. Ekzaminimi i trupit të femrës del të jetë një terren në kuadër të të cilit ndërtohet baza për një familje e shoqëri të "shëndoshë", çudituni!

Trajtimi i trupit të gruas është refleksion i pozitës, kontekstit shoqëror e kulturor. Përtej vetes, ajo është vetëm 'tjetra' që rrezikon kornizën dhe jashtë së cilës mund të mbetet.

Derisa trupi i femrës rikthehet në debat, atëherë pse gratë të mos e përdorin trupin si revoltë apo protestë.

Rosi Braidotti pretendon se të qenit grua është gjithmonë një parakusht ontologjik i ekzistencës për t'u bërë subjekt.

Çudituni me 8 Marsin, prandaj urime!

(Autorja është menaxhere e projekteve në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore)

KOSOVA VAZHDON TË MOS E KETË TË RREGULLUAR ME LIGJ ÇËSHTJEN E NGACMIMIT SEKSUAL

Ligji kundër ngacmimit seksual, i domosdoshëm

Selviqe Bajrami

Nga qyteti i Vushtrrisë kishte udhëtuar çdo ditë për në Prishtinë ku po ndiqte studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Kishte përfunduar në afat të gjitha provimet e vitit të parë. Por, Teuta, kishte ngelur prapa në njërin nga provimet e vitit të dytë në këtë fakultet. Profesori tek i cili ajo do të hynte në provim, ia kishte dërguar një mbushje të telefonit në numrin e saj personal. Këtë, Teuta e kishte kuptuar tek më vonë, dhe atë, pas dy jave, përkatësisht një ditë para se të hynte në provim.

“Shkova në fakultet për ta shikuar nëse është provimi ditën e nesërme dhe e takova profesorin. Ai ma konfirmoi atë dhe më tha “hajt se nuk është problem për ty”, tregon Teuta.

“Thirrëm më vonë në telefon e mund të dalim të pimë nga një”, citon Teuta fjalët e profesorit. Teuta ishte shtangur ngase nuk po kuptonte se çfarë po ndodhë. “Nëse nuk ke të holla në telefon, ta dërgoj sërish një mbushje. a e ke numrin 044...” i kishte thënë më tej profesori.

Nga aty Teuta ishte larguar me qëllim që të nesërmen të vinte në provim. Në mbrëmje në mobilin e saj i kishte arritur një mesazh. “Mezi spo pres me të pa nesër”, i kishte shkruar profesori.

Teuta e ka prejardhjen nga një fshat i Vushtrrisë. Ishte shastisur nga mesazhi i profesorit.

“Nuk shkova në provim dhe në shtëpi iu thash se ma kanë shty provimin”, thotë ajo.

Në tri afate, ajo kishte refuzuar të hynte në provim. kur e kishte parë profesorin në fakultet, ajo e kishte lakuar drejtimin. Por pas tri afateve, ajo kishte hyrë dhe e kishte kaluar provimin.

“Pata ardhur nga një qytet tjetër dhe isha në fillim të vitit të dytë e nuk e dija as si të veproja. Dikur u mbusha mend që ta injoroj e të mos i flas, por fillimisht, ra ai profesor dhe i humba tri afate”, tregon Teuta.

Ngacimet seksuale në UP

Tërë kjo, Teutës i ka ngjarë në vitin 2009. Por, në Universitetin e Prishtinës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, kishte kuptuar qysh në vitin 2006, se ka raste të shpeshta të ngacimeve seksuale nga ana e profesorëve.


Drejtoresha e qendrës Luljeta Vuniqi, tregon se asokohe ishin publikuar disa shkrime në media ku ishin bërë publike disa raste të tilla në universitet.

Ky fakt, kishte shtyrë qendrën që të niste konsultat me profesorët, shoqërinë civile e me anketimin e studentëve, për të parë gjendjen reale në universitet.

“Pas atyre artikujve e kemi parë që është shumë me rëndësi ta adresojmë problemin dhe jemi interturu me pa a ka politika të tilla në universitet dhe e kemi parë që nuk ka. Kemi kuptuar që kjo çështje nuk rregullohet në mënyrë specifike dhe jemi informu mirë dhe në kushte anonimiteti kemi dëgjuar shumë raste të vajzave të reja të cilat janë kushtëzuar për notë”, tregon Vuniqi.

Qendra e kishte themeluar grupin punues i cili edhe e kishte hartuar një politikë që do ti shërbente Universitetit të Prishtinës për marrjen e masave ndaj profesorëve “ngacmues”.

Politikën e kishin përpiluar dhe dërguar në universitet, asokohe kur rektor ishte Arsim Bajrami. Iu ishte premtuar se këtë çështje do ta procedojnë më tutje në senat por një gjë e tillë, nuk kishte ngjarë. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe me rektorin tjetër Enver Hasani. Universitetit të Prishtinës vetëm iu



kishte shtuar një letër më shumë e cila nuk e ka gëzuar fatin që të procedohet më tutje e të vihet në praktikë.

Raste të shumta në institucionet publike

Ndonëse Universiteti i Prishtinës e kishte injoruar këtë politikë, Qendra, sipas drejtoreshës Vuniqi nuk ishte ndalur, ani pse kishte menduar që është me rëndësi që universiteti publik të ketë një politikë të tillë.

Qeveria s' e politikën që e ka sponsoruar vet

Qendra kishte nisur anketimin në institucione të tjera publike në vend. nga intervistimet dhe anketat kishte konstatuar se ka numër të madh të personave që kanë dëgjuar për këto raste por edhe të tillë, që në mënyrë direkte janë ballafaquar me këto raste.

“Zakonisht ngacimet e tipit më të rëndë bëhen në katër sy dhe është problem që t' i argumentojmë por në bazë të anketave dhe intervistave, ka dalë një numër i madh i njerëzve që iu ka ndodhë apo që kanë ditë që janë këto raste”, thotë Vuniqi.

Hulumtimi ishte publikuar dhe

kishte hasur në vesh të shurdhër. Edhe kjo neglizhencë, nuk e kishte ndalur qendrën. Qendra kishte mbledhur përfaqësues nga të gjitha institucionet që ta hartojnë një politikë kundër ngacmimit seksual e ta procedojnë më tutje për tu bërë dokument valid sipas të të cilit do të parandalohet ngacmimi seksual por edhe do të dënohen rastet e tilla.

“Politika ka nisur së pari me qartësimin e koncepteve, i kemi përkthyer një nga një se çka është ngacmimi seksual, njerëzit nuk e dinë se ngacmim seksual është edhe nëse të thuhet ndonjë fjalë e pakëndshme apo edhe ndonjë gjest, apo edhe tregimi i barsolave të pakëndshme”, thotë ajo.

Ndonëse ishte hartuar nga përfaqësues të të gjitha institucioneve, e madje ishte sponsoruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Politika kundër Ngacmimit Seksual nuk është miratuar asnjëherë.

“Vetëm një herë është diskutuar në qeveri dhe nuk ka kaluar. Arsyetim zyrtar nuk kemi pasur ndërsa jo zyrtar ka qenë se “nuk kemi ne raste të tilla”, thotë Vuniqi.

Qeverisë i mjafton ligji kundër diskriminimit

“Po është e vërtetë që Qeveria dikur në vitin 2008-2009 ka inicuar

një draft, kundër ngacmimit seksual, por nuk është proceduar më tej. Arsyet nuk i di, sepse nuk kam qenë atë kohë këtu”, thotë në anën tjetër udhëheqësi i zyrës ligjore në Qeverinë e Kosovës, Besim Kajtazi.

Por, tani qeveria sipas tij, po punon në ligjin e ri kundër diskriminimit, ku në të përfshihet një nen kundër ngacimeve seksuale, për të cilin ai thotë se janë në finale të hartimit të projektligjit.

“Ky është një projekt i përbashkët në mes të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian i titulluar “Avancimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë”, ka thënë ai.

Qëllimi i ligjit, sipas tij, është që të vendoset një kornizë e përgjithshme për luftimin e diskriminimit në shumë fusha, në mesin e tyre është edhe neni mbi ngacmimet.

“Ngacimet (duke përfshirë edhe ngacimin seksual), kjo çështje është përcaktuar në Nenin 3 (paragrafi 2): Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në çfarëdo baze të përmendur në Nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo ka efekt të zhvleftësimi apo dëmtimit të njohjes, gëzimit apo ushtrimit, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës”, ka

Në Kosovë mungon ligji që i dënon rastet e ngacmimit seksual. Raste të tilla ka me bollëk dhe për këtë, Qendra Kosovare për Studime gjinore po e kërkon një ligj për këtë çështje. Qeveria thotë se mjafton Ligji kundër diskriminimit

squaruar ai duke mos precizuar nëse Kosovës i nevojitet një ligj i veçantë kundër ngacmimit seksual.

“Ngacmimi konsiderohet diskriminim, kur një sjellje kundër dëshirës (që përfshin por nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike) dhe që bazohet në një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në Nenin 1, e cila ka për qëllim apo ndikim në shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues dhe fytes bazuar në një apo më shumë baza, reale apo të supozuara, siç janë të përcaktuara në Nenin 1”, ka thënë ai teksa ka shtuar se këtë draft për komente tek komisioni evropian, dhe po presim përgjigjet nga ata, gjatë këtij muaji. Më pas do vazhdojmë me procedurat tjera që dërgojnë deri tek miratimi i ligjit.

por pavarësisht kësaj, me pretendimin se sjellja seksiste në Kosovë është e legjitimuar gjithkrah dhe madhe shumë pak është kah bëhet për të. Luljeta Vuniqi thotë se qendra që ajo drejton nuk do të dorëzohet që ta jetësoj një Politikë të veçantë kundër ngacmimit seksual.

“Qendra planifikon që të kontaktoj ministrat veç e veç edhe me i njoftu për politikën, dhe më pas të llobojmë sa më shumë”, ka përfunduar ajo.

Zemrat

Artiana Matoshi

Një fletore pune e Kuvendit të Kosovës përmbante aq shumë “urtësi” e margaritarë për gratë, sa që shprehte karakterin dhe psikën e shumicës absolute të parlamentarëve kosovarë, këtyre burrave të dheut, që prirjet e tyre despotike nuk dinë as t’i kamuflonjë. “Heshtja është ari i vetëm që kanë femrat”, dhe “Heshtja dhe modestia janë stolia më e bukur e gruas”, ishin disa nga “fjalët e urta” të shkruara në disa fletore pune të dhuruara nga Kuvendi i Kosovës, për deputetet e këtij kuvendi. Deputetet e Kuvendit të Kosovës, dhuratë të vitit të ri 2012, kishin marrë këto fletore, ku në çdo faqe kishte thënie të “mençura”, nga mendimtarë të ndryshëm. Thënie si “Gruaja mbetet pa fjalë vetëm kur e puth” apo “Te femra gjithçka është zemër, bile edhe koka”, bënë që të reagonin vetë deputetet. E para që shprehu shqetësimin për këto thënie denigruese ndaj femrave, ishte deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, e cila e kishte ngritur këtë çështje edhe në Kuvend, duke thënë se këto “fjalë të urta” janë poshtëruese. Me këto thënie, apo “fjalë të urta” popullore, nuk përfundoi asnjëherë fyerja e femrave në Kuvendin e Kosovës. Njohja ligjore e grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë, si viktimat të dhunës, ka ngritur debate të shumta. Deputetë të Kuvendit të Kosovës, kryesisht ata të pozitës kanë kundërshtuar ligjin për shkaqe të koston dhe mungesës së të dhënave për numrin e tyre. Nga deklaratat e deputetëve, të fyera janë ndier gratë, e sidomos ato të dhunuara. Deputeti i PDK-së, Shaip Muja, duke kundërshtuar këtë projektligj, ka thënë se gratë e dhunuara në luftë, nuk mund të quhen viktimat. “Nuk mundesh me i quajt viktimat, sepse nuk janë të vrara. Viktimat janë të vrarët”, pati deklaruar Muja. Ka edhe nga ata deputetë, që ‘bregosen’ për metodat gjinekologjike dhe diagnostikimin e tyre. “Nuk ka metodë ligjore obstetrike, gjinekologjike, për të diagnostikuar dhunimin e para 12 vjetëve”, është shprehur deputeti i Partisë së Drejtësisë, Gëzim Kelmendi. E kush do të gënente për një fakt të tillë!!! I dhimbshëm, madje trishtues, është fakti se kundër propozimit për t’i mbrojtur me ligj viktimat e dhunës seksuale dolën edhe tre gra të PDK-së, dy të AKR-së dhe tre të partive etnike. Madje, më e keqja nga këto, ishin deklaratat e këtyre grave. Deputetja Flora Brovina, njëkohësisht aktiviste për të drejtat e njeriut, ka kundërshtuar atë projektligj. “Së pari duhet konstatuar se çfarë dokumentesh duhet të kërkohen për ta vërtetuar këtë abuzim”, kishte thënë Brovina, e cila ka deklaruar se që nga viti 1998 merret me fatin e këtyre grave. E, disa nga to, edhe përkundër mendimit se shoqëria jonë i ka borxh kësaj kategorie, bregosen më shumë për koston. Deputetja e PDK-së, Safete Hadëgjona, kishte propozuar që në atë seancë të mos votohet ai projektligj, sepse sipas saj, prodhon kosto shtesë të lartë buxhetore. Kjo gjuhë maskuliste (seksiste) dhe denigruese, e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, shkaktoi shumë reagime që u



përcollën me një protestë simbolike, ku shumë gra patën dalë në rrugë, para Kuvendit, sepse sipas tyre, deputetët kanë fyer dinjitetin njerëzor. E, jo larg Kuvendit të Kosovës, në një sallë të Komunës së Prishtinës, në ditën e të dashuruarve, po kurorëzoheshin 29 çifte të reja. I pranishëm në ceremoni ishte edhe i pari i komunës, Shpend Ahmeti. Kryetari i ri, edhe pse në rrjetet sociale, shfaq goxha dashuri për gruan e tij, në atë ceremoni edhe pse me shaka ofendoi femrat. Më së shumti ato që po kurorëzoheshin atë ditë. Duke ua uruar çifteve martesën, Ahmeti u tha meshkujve me shaka: “Nuk po e dini çka po i bëni vetit”!

E, po siç thotë populli ‘shakaja gjysma e së vërtetës’. Pse janë gjithmonë meshkujt ata që dënohen sapo martohen?! Ndoshta duhet ta pyesim Shpend Ahmetin ...

”Zogu” më i mirë i Qeverisë

Ministra e Integritimit, Vlora Çitaku, shpeshherë është bërë pre e ofendimeve dhe shprehjeve seksiste. Mediat online keqpër-

Vetëm në një vend tribal (ku fiset luftojnë për primat), në një vend despotik si Kosova, tributë dhe despotët për dominimin e shoqërisë e “fshijnë” gruan nga historia dhe moderniteti përmes poshtërimit, skllavërimit modern. Gratë përfaqësojnë gjysmën e një kombi, prandaj lërimi zemrat të lira...

dorën fotografitë e Çitakut, të postuara në rrjetet sociale, për të bërë ‘lajm’ për ministrin. Madje, nuk hezituan që atë ta krahasojnë me ‘seks simbolet’ e estradës kosovare. Për pamjen e Çitakut, ka folur edhe kryeministri serb Ivica Dačić. Ky i fundit ka fyer ministrin, në një takim me liderët shqiptarë të Luginës së Preshevës, dhe ka bërë që takimi të

“Heshtja është ari i vetëm që kanë femrat”, dhe “Heshtja dhe modestia janë stolia më e bukur e gruas”, ishin disa nga “fjalët e urta” të shkruara në disa fletore pune të dhuruara nga Kuvendi i Kosovës, për deputetet e këtij Kuvendi

dalë jashtë kontrollit. Dačić ka thënë se po të kishte qenë në Beograd, kur Çitaku e ka vizituar kryeqytetin serb, do të kishte kaluar më mirë. “Nuk isha unë në Beograd kur ka ardhur ajo e

bukura nga Kosova për vizitë, se me siguri do të kishte kaluar më mirë”, kishte thënë Dačić, duke iu referuar vizitës së ministres për Integritim Evropiane, e cila në muajin qershor të vitit të kaluar, u bë zyrtarja e parë kosovare që ka vizituar kryeqytetin serb. E fyer, Vlora Çitaku nuk mbeti vetëm nga kryeministri serb. Atë e ofendoi edhe një deputet i Kuvendit të Kosovës. Një deklaratë e deputetit të LDK-së, Arben Gashi, ka bërë që të gjitha deputetët ta lëshojnë seancën e Kuvendit të Kosovës. Duke kritikuar diplomacinë e Kosovës, Gashi ka folur edhe për ministrin e Integritimit, Vlora Çitaku, duke thënë se ‘ajo nuk po bën asgjë, por vetëm po përqafet me burra të huaj nëpër takime jashtë vendit’. Pas reagimit të deputetëve, të cilat kërkuan kërkim falje nga Gashi për gjuhën ofenduese, ky i fundit ka kërkuar falje, duke thënë se qëllimi i tij nuk ishte që ta fyente askënd.

Mediet dhe gjuha seksiste

Përveç shkrimit për ministrin Vlora Çitaku, një pjesë e medieve

online kanë fyer presidenten Atifeta Jahjaga, duke postuar një foto të saj, në të cilën vëreheshin ‘tangat’ e presidentes. Dikush kishte shfrytëzuar rastin, të fotografonte presidenten e Kosovës, në një pozicion të sikletshëm. Jahjaga u fotografua nga mbrapa, ku pas pantallonave të zi, asaj i vëreheshin edhe ‘tangat’. Kjo fotografi u publikua në një portal e mandej u shpërnda gjithandej. Nga njerëz me ndikim, fotografimi i presidentes nga mbrapa dhe postimi i asaj fotografie, u dënua dhe u cilësua si gjest i ulët, nuk u ndalën qytetarët të përdorin lloj-lloj fjalësh për Jahjagën. Presidentja Jahjaga, është bërë cak i ofendimeve edhe në rrjetet sociale, ku ekzistojnë me qindra faqe të hapura kundër saj. Edhe gazetari Milaim Zeka ka hyrë në mesin e fytyrave publike, me deklaratat fyese për femrat. Zeka në një konferencë për shtyp në vitin 2010, pati fyer koleget e tij, pasi që nuk i kishin pëlqyer pyetjet që ato po i bënin. Zeka kishte ofenduar gazetaren Liridona Lluka-Gashi, duke i thënë “Lopë e Danimarkës”. Ky ofendim ndaj gazetares, pati ngjallur shumë reagime. Rastin e kishte dënuar edhe mediu i në të cilin Zeka punon. RTK. Por, reagimet nuk e ndaluan gazetarin Milaim Zeka. Pas tri viteve, ky gazetar ka fyer edhe një gazetare tjetër. Pas një shkrimi të gazetares Saranda Ramaj në “Koha Ditore”, e cila kishte raportuar për një takim të Milaim Zekës me Sami Lushakun, Zeka në rrjetin social “Facebook” ka thënë për gazetaren Ramaj se ka burime që ajo kishte qëndruar në një hotel me një polic italian.

Femra dhe predikuesit hipokritë

Femra gjithmonë është vlerësuar më pak nëse nuk është virgjëreshë. E, hoxhë Irfan Salihu ka përcmuar, fyer dhe denigruar publikun kosovar, përmes një predikimi të tij para xhematit, ku ka fyer rëndë femrat shqiptare. Irfan Salihu gjatë ‘ligjëratës’ së tij e ka krahasuar një vajzë jo të virgjër me një gomë të përdorur makine. Ky hoxhë, u ka bërë apel të rinjve kosovarë që këto ‘kurva’ e ‘rrospia’ t’i hedhin sokaqeve si mbeturina. Kjo është fyerja më e madhe që dikush ndonjëherë i ka bërë gruas.

Pas publikimit të videos së hoxhës, ka pasur reagime të ashpra edhe nga Grupi i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, të cilat e kanë cilësuar gjuhë denigruese ‘predikimin’ që ka bërë hoxha.

Pas hoxhës, debat ngjalli edhe një këngë. Ishte rap-këngëtar Gold AG që me një këngë të tij ka fyer shumë fytyra publike të Kosovës, përfshirë presidenten Atifeta Jahjaga. Gold AG, nuk ofendoi femrat, por hoxhallarët dolën në mbrojtje të tij, pasi që ky u ftua në polici për nxitje të urrejtjes. Përveç Shefqet Krasniqit, rap-këngëtarit Arian Agushit, në mbrojtje i doli edhe deputeti Amir Ahmeti. Ky deputet, dikur pjesë e Partisë së Drejtësisë, tash i pavarur, ftesën në polici ndaj këngëtarit e ka cilësuar “Gjueti shtrigash”. “Antiteistët, islamofobët dhe shteti ateist në aksion ‘në gjuajtjen e shtrigave’ turp”, ka shkruar Ahmeti në rrjetin social “Facebook”. Deputet i nderuar, pse të mos jetë “Gjueti shtriganësh”, kjo shprehje. Pse duhet që gjithmonë të preket një femër e jo një ‘burrë’!? Shumë fat për 8 Mars!

Meshkujt në objektivin e saj

Të qenit femër, thotë se nuk i ka krijuar avantazhe në punë. Kur është në pyetje fotografia Laura mburret se punën e bën shpesh edhe më mirë se një mashkull

Donjeta Demolli

Ajo shkruan dhe flet shkurt dhe me ato pak fjalë i jep shumë kuptim asaj që thotë. Sikur edhe fotografia që flet sa 1000 fjalë. Lura Hasani është fotografe në Kosovë. Është nga të rrallat që e shoh me aparat fotografie në dorë. Hasani punon në të përditshmën Zëri.

Pasioni i saj për fotografinë kishte lindur thjeshtë, madje qysh atëherë kur nuk dinte të lëxonte dhe shkruante.

“Jam rritur me gazetën “Rilindja” meqë babai im punonte në atë të përditshme dhe e sillte çdo herë në shtëpi. Si e vogël, kur nuk dija shkrim-lexim, i shikoja vetëm fotografitë dhe mbase, aty mund të këtë lindur pasioni im për fotografinë. Më vonë edhe motra ime punoi dhe u mor me fotografi po në “Rilindje” dhe pasioni im për fotografinë u shtua edhe më shumë. Fillova ta ushtrroj profesionin e fotoreporteres që nga vitet e 90-ta”, tregon ajo.

Laura thotë se vështirësitë e saja kanë qenë të natyrshme si në cdo profesion tjetër të cdo njeriu. Të qenit femër, thotë se nuk është se i ka krijuar avantazhe në punë. Kur është në pyetje fotografia Laura mburret se punën e bën shpesh edhe më mirë se një mashkull.

Gjinia e fotografisë

E meshkujt kanë qenë më së shumti në objektivin e saj. Dhe si është të fotografosh kryesisht burra në politikë për një fotografi?

“Si të vizitosh dhe fotografosh një odë burrash në kullat tipike shqiptare, aty ku duket sikur gruaja nuk ekziston”, shprehet ajo.

Ndryshe nga kjo, fotografia e saj për gruan do të ishte një rrëfim për një ecje të vështirë krah burrit, “një grua që mbanë në supe peripeci të mbijetesës, sakrificës për të ardhmen, njolla gjaku të luftës për çlirim kombëtar dhe krenari për ecjen përballë meshkujve në të gjitha sferat e jetës dhe punës”.



Ka kohë që punon në gazetë si fotoreportere, por edhe sot vlerëson se mediat nuk i kushtojnë rëndësi fotografisë. “Në Kosovë fatkeqësisht mediat janë të koncentruara shumë në tekst, në fjalë, bile edhe televizionet ndonëse e kanë mundësinë e artë të pamjeve filmike”, shton Laura Hasani, teksa vlerëson se ka media që kanë filluar të ndryshojnë këtë

Përtej këtyre, në punën e saj Laura nuk bën dallime. Ajo thotë se një profesionist në fotografi i jep rëndësi tregimit që kushdo ka për ta thënë.

“Besoj shumë në të drejtën e secilit që ndoshta edhe përmes fotografisë time të ndjehet rahat ta thotë gjithë atë që e ka në shpirt, lotët e gëzimit apo hidhërimit”.

Puna si fotoreportere nuk ka kohë dhe vend. Ajo të sjellë në cdo hapësirë në cdo orë. Në një punë të tillë dhe të jesh femër, shpesh ndoshta mund të ketë paragjykime gjinore. Për kaq vjet kjo nuk ka ndodhur me Laurën. Ajo thotë se gjithmonë gjen mbështetje nga kolegët, që janë meshkuj kryesisht. “Sa herë dal në terren dhe bëhet

fjalë për ngjarje të rënda, të ndjeshme me persona që japin shenja se duan të fillojnë provokimet, gjithmonë gjej mbështetje dhe përkrahje nga kolegët e mi, qofshin ata gazetarë apo fotografë të mediave të tjera. Në këtë rast më duhet patjetër të përmend kolegët e mi Hazir Reka nga Reuters dhe Alban Bujari nga Koha Ditore që më janë gjetur pranë në momente të vështira“ deklaron ajo.

Se fotografia vlen sa 1000 fjalë nuk është gjithmonë shkas i një shkrepeje. Ajo është një përpjekje e madhe për të treguar të vërtetën, të kuptosh ngjarjen, jetën dhe kulturën e një individi, populli.

“Normalisht me kalimin e kohës

duke u përballur me situata nga më të ndryshmet, të ndjeshme, të rrezikshme etj, dhe nëse deri më sot vazhdoj të jem aktive profesionalisht e kam arritur nivelin e duhur të përmbytjes. Sidoqoftë, është e natyrshme të ndjesh me viktimën, ndoshta edhe të qash me ta, por në cdo rast, pikë së pari për hir të profesionalizmit tënd, duhet të tregosh nivelin e mjaftueshëm të përmbytjes”.

Të inspirohesh nga një mashkull

Zhvillimi i teknologjisë ka prekur shumë sfera të jetës. Kjo pashmangshëm edhe fotografinë. Laura thotë se megjithatë ka mbetur dicka që nuk

Të dëgjosh, të ndërhysh, të kesh mendim

Filloi karrierën e saj si gazetarë në kohën kur solidariteti në mes të shqiptarëve ishte në kulmin e tij. Për vite punoi në një revistë për të rinj. Përveç faktorëve të tjerë që u jepnin forcë të gjithëve në vitet e '90, Ardiana Pajaziti kishte edhe një forcë që i shumëfishon të gjitha të tjerat, ririnë.

Ajo tani drejton medien e vetme online kushtuar kulturës, kultplus.com. Rrugën deri këtu ajo e ka trasuar me përvojën e saj në disa media vendore, si shumë kolegë të saj të cilët kalojnë sfida të ndryshme në tregun medial në Kosovë. Por, guximi dhe besimi për të hapur këtë medie në kohën kur në Kosovë ka me qindra portale të tjera, atë e dallon nga gazetarët e tjerë.

Gazetarinë e shoh si mjeshtri të cilën e përvetëson me kalimin e viteve. Por, sa më shumë që e njeh profesionin e gazetares, ka frikë më të madhe po nga ky profesion që e ka përcjellë në pjesën më të madhe të jetës. “Ndoshta për faktin se tashmë ke krijuar identitetin profesional dhe përgjegjësi ndaj anës profesionale rritet edhe më shumë”, shprehet Pajaziti. Për të, gazetari si zanatli kalon nëpër disa faza gjatë karrierës: “Në fazën e parë duhet të dëgjosh të tjerët, në fazën tjetër fillon edhe ti të ndërhysh, dhe më pas edhe faza e shprehjes së mendimit e deri te lufta për tu aprovuar pikërisht ai mendim.”

Ndryshe nga institucionet e tjera, kryesisht shtetërore, ku prania e femrës si lidere është më e vogël, në gazetari Pajaziti dhe dy kolege të saj kanë ndryshuar këtë trend. Ajo thotë se në sistemin dhe kohën në të cilën jetojmë, ndryshimi vjen së pari nga institucionet për të ndikuar më pas edhe tek perceptimi ndaj lidershit të femrës. Për këtë ajo merr shembull

vendet Skandinave. “Nëse i marrim shembull këto vende, është një sinjal i qartë, se nëse rregullohet mbështetja e femrës edhe me ligj, atëherë edhe femra është me vetëbesim më të madh”, thotë ajo.

Shpirt artisti kanë edhe gazetarët e artit. Puna e tyre vazhdon të trajtohet si lajm i dorës së dytë nga vet redaktorët e tyre, e megjithëkëtë ata vazhdojnë të përmbyshin misionin e tyre, edhe kur kompensimi material nuk

është i barabartë me kolegët e tjerë që mbulojnë politikën, apo ekonominë. Në lajme qendrore rrallëherë raportohet për kulturë, edhe atëherë kur një gjë e tillë bëhet, ajo storie vendoset krejt në fund të edicionit. E irrituar nga ky fakt, ish-gazetarja e kulturës mori vendim për të hapur portalin e vet i cili tanimë ka rreth 20,000 ndjekës në Facebook. Dy faqe kulturë në gazetën ditore, për Pajazitin janë të pamjaftueshme të mbulojnë zhvil-

limet kulturore në vend. “Ose, ato që përfshihen, cungohen aq shumë, sa më shumë dalin qesharake me atë që plasohet se sa përmbyshet misioni”, thotë ajo.

Nëna e dy vajzave, Anna dhe Ninna, ka konceptuar vet portalin Kultplus. E ndërsa shprehjen e famshme “Pas cdo mashkulli të suksesshëm është një grua”, Pajaziti e ka përmbysur për të krijuar një model të femrës udhëheqëse në Kosovë.

Bashkëshorti i saj i ka qëndruar gjithmonë pranë për ta mbështetur atë, ndërsa ajo vet i gëzohet arritjeve të femrave në fushën e kulturës. “Natyrisht që ndihemi jashtëzakonisht mirë kur shkruajmë për sukseset e njëpasnjëshme të regjisores Lendita Zeqiri me filmin ‘Ballkoni’, pastaj Vjosa Berisha që po udhëheqë festivalin e filmit ‘PriFest’...”, shprehet Pajaziti.

Vetë ndjeshmëria e femrës është kulturë në vete. Ky është përkufizimi për raportin femër: kulturë kosovare që i bënë Pajaziti. “Dhe duhet ta kemi parasysh se femra në kulturën shqiptare nuk po ndodhë vetëm në vitet e fundit. Nëse e kujtojmë Katarina Josipin atëherë e kemi të qartë se rrugëtimi i femrës kosovare me artin është shumë i hershëm.”

Nga Katerina Josipi, ajo femrën e sotme kosovare do ta shohë “aty ku është Rita Ora e Arta Dobrosht.”

Pajaziti e shoh punën e gazetares sikur të punosh çdo ditë nga e para. Por kjo nuk është tregues për suksesin e portalit të saj i cili së fundi është bërë pikë referimi e lexuesve dhe artistëve nga vendet e banuara me shqiptarë.

Të gjithë ata që duan të informohen për ngjarjet kulturore, në kultplus mund të gjejnë artikuj nga teatri, filmi, arti pamor, libri e trashëgimia, pa munguar edhe pjesa e muzikës, shoubizit, diasporës e fëmijëve.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij portali është edhe rëndësia që i jepet fotografive. Secili tekst është i shoqëruar nga dy e më shumë fotografi për ta bërë këtë ueb-site të duket atraktiv.

Pajaziti ka synim që të promovojë kulturën e mirëfilltë dhe talentet e të rinjve.

D. D.



Ardiana Pajaziti, gazetarinë e shoh si mjeshtri të cilën e përvetëson me kalimin e viteve. Por, sa më shumë që e njeh profesionin e gazetares, ka frikë më të madhe po nga ky profesion që e ka përcjellë në pjesën më të madhe të jetës

VËSHTRIM

Më shumë gra në politikë, më shumë talent për vendin



Anna Di Lellio

Nuk kishte kuota gjinore që e detyruan kryeministrin e ri të Italisë, Matteo Renzi, të përfshinte gra në kabinetin e tij muajin e kaluar. Por, ai e bëri këtë. Gjysma e ministrave të tij janë femra. Ky është përparim i madh për pjesëmarrjen e femrave në politikën italiane, të cilat falë kuotave, përbëjnë rreth 30% të anëtarëve të Parlamentit. Mbetet të shihet se çfarë ndryshimesh do të sjellin këto femra në politikë, ose në kushtet e femrave në shoqëri. Mbase ndryshimi nuk do të jetë i shpejtë, ose menjëherë i dukshëm. Tash për tash, mjafton të shihen më shumë femra në televizor duke mbajtur fjalime për politikën dhe jashtë ose për të njoftuar për planet kombëtare të mbrojtjes – një kundërpeshë e mirë për shumë nga ato që dalin në të njëjtin ekran, të veshura në mënyrë provokuese, e që nuk thonë asgjë inteligjente. Të gjitha femrat e reja që e shikonin televizorin do ta kuptojnë më mirë se ato nuk kanë pse t'i bashkohet industrisë argëtuese/të modës për të qenë dikush. Ato mund të bëhen udhëheqëse të cilat e drejtojnë vendin. Dhe vendi do të përfitojë nga zgjedhja e liderëve të tij nga një grup më i madh i qytetarëve, përfshirë atë gjysmën e popullatës që është e marginal-

izuar gjithmonë, megjithëse kanë treguar kapacitete të larta, energji dhe inteligjencë.

Në shikim të parë, Kosova nuk duket keq në këtë aspekt. Presidentja e Republikës, Atifete Jahjaga, është njëra nga 8 krerët shtetërorë femra në botë. Një kuotë prej 30% femra është miratuar shumë kohë më herët – si rezultat i trysnisë nga bashkësia ndërkombëtare – dhe siguron zgjedhjen e femrave në Parlament. Megjithatë, ky nivel në dukje i mirë i përfaqësimi ende shihet me dyshim dhe mungon besimi që meriton. Ku janë problemet?

Në një formë, pjesëmarrja e grave ende shihet si “dhuratë” që u është dhënë atyre nga elita politike. Ky është rasti në radhë të parë i presidentes, e cila është shfaqur si deus ex-machina në fund të një lufte shumë të hidhur politike për ta zënë atë post. Por, si do të mund të zgjidhej ndryshe presidentja? Presidenca nuk është një post që zgjidhet, sipas Kushtetutës, pasi që ai del nga negociatat mes partive kryesore. Presidentja Jahjaga ishte në fakt zgjidhja e ngërcit në të cilin kishte rënë legjislatura. Tash kur udhëton jashtë vendit, ajo e përfaqëson vendin në mënyrë të përkryer, siç e kam parë të vepronte në Shtetet e Bashkuara dhe e kam dëgjuar të vepronte në Mbretërinë e Bashkuar. Kudo që ajo shkon, merr nota të larta në vendet pritëse. Ndoshta pse është femër, ajo tregon një pasqyrim të papritur përparimtar të Kosovës, që thyen stereotipet e kamotshme të cilat e përkufizojnë këtë vend si tradicionalist dhe të prapambetur.

Në Parlament, kuotat ndihmojnë

me të madhe, pasi që femrat nuk kanë organizatën e pavarur dhe fondet për t'u kandiduar për poste. Edhe po t'i kishin, nuk do të mjaftonin. Të gjithë kandidatët varen me të madhe nga partitë politike për t'i përfshirë ato në listat e tyre dhe për t'i mbështetur ato në procesin zgjedhor. Kjo vlen edhe më shumë për femrat. Por, kjo nuk do të thotë se ato nuk mund të fitojnë vota vetë. Shumë varet nga ajo se kush janë kandidatet femra. Që partitë politike të tregojnë lidhshmëri në këtë fushë, nuk mjafton që vetëm të aplikojnë kuotat gjinore. Ky është ligji, që funksionon si mundësi e dhënë femrave, si një grup në pozitë më të pafavorshme për të hyrë në garë. Çfarë tjetër kërkohet nga udhëheqja është përfshirja dhe promovimi i grave të zonja të cilat mund të fitojnë vota me meritë.

Një studim i kohëve të fundit i trendëve zgjedhorë të Kosovës nga instituti hulumtues D4D tregon se në vend të përmirësimit, cilësia e pjesëmarrjes së femrave është duke ecur mbrapsht. Pasi që sistemi zgjedhor ka kaluar nga lista të mbyllura në lista të hapura, dhe nga një alternativë në shumë alternative, ka qenë e mundshme të matet se cilat femra kanë fituar me meritë të vetën dhe cilat kanë përfituar ekskluzivisht nga kuotat. Në vitin 2007, 16 nga 37 femrat deputete u zgjodhën me meritë dhe të tjerave iu siguroa nga një ulëse sipas kuotave. Në vitin 2010, vetëm 14 femra u zgjodhën me meritë. Partia që prin është LDK-ja me katër femra të zgjedhura me meritë nga tetë sa garonin në vitin 2007, por shumë më shumë në

vitin 2010, shtatë nga nëntë. Në fund është PDK-ja që zgjodhi me meritë gjysmën e 12 deputeteve të tyre në vitin 2007, por vetëm dy në vitin 2010.

Një interpretim i mbrapshtë i këtyre shifrave do të nxirrte përfundimin se gratë mund të bëhen deputete vetëm për shkak të kuotave. Me fjalë të tjera, puna si deputete u dhurohet atyre nga një sistem politik i dizajnuar nga bashkësia ndërkombëtare që i kanë imponuar kuotat dhe i zbatuar nga partitë politike të cilat nuk çajnë kokën për ata që i zgjedhin për ta udhëhequr vendin. Të vetmuara, gratë nuk do të mund të fitonin ulëset e tyre.

Një lexim tjetër është më i përshtatshëm. Mbase femrat e përfshira në listë nuk ishin më të mirat për atë punë. Atëherë, përgjegjësia për këtë bie mbi udhëheqjen, e cila duhet të bëjë punë më të mirë në përzgjedhjen e kandidatëve. Por, duhet të merret parasysh edhe një mundësi tjetër: pavarësisht sa mundohen partitë, ato nuk mund të gjejnë kandidatet më të mira pasi që ato mund të mos i tërheqë politika. Nëse kështu është puna, është shumë e vështirë të plotësohen listat me kandidate kompetente. Edhe në këtë rast, përgjegjësia është e udhëheqjes, sepse ata kanë krijuar një hendek besimi mes politikës dhe qytetarëve dhe se nuk janë në gjendje ta plotësojnë atë.

Zgjedhja e Mimoza Kusari-Lilës, kryetare e Gjakovës, është dëshmi e qartë se femrat e zonja dhe të shkëlqyera, të cilat janë të gatshme të angazhohen në politikë, mund të

fitojnë me meritë. Si anëtare e partisë AKR, që nuk është një nga partitë më të mëdha, ajo do të kishte edhe më pak gjasa se të tjerat për të fituar zgjedhjet. Megjithatë, ajo ia doli të korrrë një fitore të madhe për veten dhe partinë, e cila përndryshe ishte e paaftë ta “pushonte” Gjakovën.

Por, kryetarja Kusari-Lila duket të jetë një përjashtim, pasi që fitorja e saj është një kombinim i rrallë i cilësive të saj personale dhe mundësiave politike. Ndonëse ka femra të tjera me cilësi të larta, atyre u duhet të kapin mundësitë të cilat do t'i katapultojnë në udhëheqje politike të vendit. Ato nuk mund ta bëjnë këtë të vetmuara. Dhe shpesh nuk mund të sigurojnë mbështetjen për të cilën kanë nevojë nga udhëheqja politike, kryesisht e dominuar nga meshkujt.

Në Shtetet e Bashkuara ekzistojnë grupe dhe lobe të grave të përkushtuara për të promovuar kandidatet femra. Lidhja e Votuesve Femra është një prej tyre. Ajo është themeluar shumë kohë më parë për të bërë fushatë për të drejtën e grave për të votuar, në kohën kur vetëm të burrat e bardhë kishin të drejtë të merreshin me politikë. Tash ajo mbrohet gjitha grupet që nuk janë të përfaqësuar sa duhet dhe femrat përbëjnë një pjesë të mirë të tyre. Ajo nuk është përkrahëse e tyre. Ose ta marrim Listën e Emilit, e cila ekskluzivisht është e përkushtuar për zgjedhjen e grave demokratike përmes fushatave dhe gjetjes së fondeve. Ato promovojnë një agjendë progresive përmes kandidatëve femra.

RECENSION

Krimi dhe përdhunimi serb kundër femrës shqiptare në Kosovë 1997-1999



Dr .sci. Resmije Kryeziu

Dhunimi si formë e luftimit të armikut është veprim barbar dhe është i pranishëm që nga lufta e Trojës deri te luftërat e sotme, duke u shtrirë anekënd globit, por askund dhe asnjëherë nuk ndodhën gjëra të atilla siç ndodhën në luftën e Kosovës, ku në të njëjtën kohë gruaja dhunohej dhe gjatë dhunimit masakrohej. Ushtria serbe, me paramilitarët e tyre, si pararojë e kësaj ushtrie që kishte një plan djallëzor të spastrimit të dhunshëm të Kosovës nga shqiptarët në këtë vepër ata na zbulohen edhe me emra të tyre, që nuk ishin vetëm vrasës, nuk ishin vetëm dhunues, ata në vete i kishin të gjitha të zezat që mund t'i ketë një mendje e dalë jashtë orbitës së njerëzore.

Fjala antologji në greqishtë do të thotë tufe lulesh. Vepra e Naxhije Doçit Krimi dhe përdhunimi serb kundër femrës shqiptare në Kosovë 1997-1999 do të mund të quhej antologji, jo e së bukurës, jo e luleve, jo e veprave më të mira, të përzgjedhura të letërsisë, të poezisë apo të prozës, por e fundajës së tmerrit në format më të përshtirë që i tejkalojnë edhe makthet më të tmerrshme që njeriu normal mund t'i paramendojë. Me këtë rast nuk kemi të bëjmë me të menduarit normal, të vepruarit

normal, por të vepruarit e kafshës që jeton në njeriun dhe kjo kategori e këtyre dy këmbësorëve me këto veprime është munduar ta shtrijë fuqinë e vet kudo që ka shkelur të pavetëdijshëm se sa më i madh tmerrri që ka ngelë pas tyre aq më shumë i ka rroposë ata në ligësi duke i larguar nga raca njerëzore. Sado që është vështirë t'i artikulojë këto vlerësime për njerëzit, një ushtri e një vendi që është pjesë e Evropës, në fund të shekullit XX, së paku gjeografikisht, faktet që na i sjell libri të cilin sot po e promovojmë të gjitha fjalët akuzuese që mund t'i them i bënë fjalë të buta përballë faktëve që ajo i shpall në këtë libër. Libri i Naxhije Doçit i referohet përkrahimit më të errët të shpirtit njerëzor, veprave të përgjakshme të ushtrisë serbe në luftën 1997-1999 ndaj popullit shqiptar në përgjithësi e ndaj gruas dhe fëmijëve në veçanti.

Libri ka 440 faqe dhe përbëhet nga parathënia, hyrja dhe njëmbëdhjetë kapituj në të cilët paraqitet tmerrri i krimeve të makinerisë luftarake serbe, nëpërmjet intervistave dhe dëshmi të subjektit që kishin përjetuar përdhunimin dhe dhunimin në Dragaçinë- Theandë; Mejë Gjakovë; Prapashiticë – Prishtinë; Kaçanik; Krushë e Madhe - Rahovec; Krushë e Vogël-Prizren; Guskë e Korenicë – Gjakovë; Podujevë; Fortesë (Bellacerkë); Klinë; Mitrovicë. Nga këto vende, të mbijetuarat me emër e mbiemër rrëfejnë për tmerrin, të gjitha llojet e dhunës të përjetuara në vitet 1997-1999, ndërsa, kur flitet për përdhunimet, fshihen pas inicialeve që turpi, pa fajin e tyre, mos të bëhet i përbotshtëm, i cili edhe ashtu gjatë do të peshojë në ndërgjegjen dhe

shpirtat e tyre. Dëshmitaret sjellin emra të kriminelëve të fshatrave të tyre, atyre që i kanë njohur, qoftë serbë, qoftë bashkëpunëtorë të tyre shqiptarë.

Vepra e Naxhije Doçit Krimi dhe përdhunimi serb kundër femrës shqiptare në Kosovë 1997-1999 është shumë vështirë për t'u lexuar edhe më vështirë për të besuar në vërtetësinë e asaj që shkruan ajo por nga dëshmitë që ofron, qëllon si me çekan, e ngjall detyrimin në njeriun se heshtja para krimeve të tilla që bëhen me qëllim që të zhdokumentet njerëzorja i bën bashkëpunësuar në këtë krim të gjithë ata që heshtin.

Libri i Naxhije Doçit është një urë që tragjedinë e gruas, vajzave, pjesës më të ndjeshme të kombit e përcjell të lexuesi me përkushtim që të mos e humbë asnjë detaj që i karakterizon rastet e të intervistuarave. Sado që detyra e saj ka qenë e vështirë, ajo duke ndrydhë dhembjen në vetvete, sado që herë-herë ka teptisë nga ajo, ka arritur që botës t'ia vërë në pah krimet e bëra të ushtrisë serbe ndaj grave dhe fëmijëve të pambrojtur shqiptarë.

Kadare në librin e tij Mbi krimin në Ballkan duke folur për Kosovën dhe heshtimin për krimet flet dhe për mosdëshminë e përdhunimeve dhe thotë se: “Përdhunimi jo vetëm do të mbetej ndoshta tmerrri më i madh i Kosovës, por do të dyzohej si i tillë, nga që ndiqej nga një tjetër tmerr: ai i mosdëshmimit. Mund të thuhet se në pranverën e fundit të mijëvjeçarit të dytë fati kishte ruajtur për vajzat dhe gratë e Kosovës, një martirizim të pashembullt, si ato që tregoheshin në shkrimet e shenjta. Ishin ato që do të paguanin çmimin më të shtrenjtë

për lirinë e Kosovës, pikërisht në prag të saj. Rrjedhimisht ishin ato , që do të meritonin njërin ndër tre memorialët e parë, atë qendrorin, midis memorialit të foshnjave të vrara dhe të luftëtarëve të lirisë, kjo nuk u bë dhe nuk po bëhet, duke u kthyer kështu në një gjymtim, j vetëm të kujtesës, por në radhë të parë të ndërgjegjes sonë.

Ato memorial do të ishin më shumë se rikrijim i një dhembjeje, më shumë se një detyrim moral. Ato do të ishin një kampanë që nuk resh kurrë, për qortimin e asaj për të cilën kanë nevojë të gjithë – të vërtetën”.

Detyra jonë –qenie e një bote, që pretendon ta quajë veten botë të civilizuar, duhet ta ngrejë zërin që të mbahen mend këto krime për të mos u përsëritur më, por të përkujtohen që të dënohen ideatorët e këtyre veprimeve bashkë me ata që këto veprime i kryen.

Ky promovim është vetëm një zë kundër oqeanit të mospërfilljes së të keqes.

Mungesa e deritanishme e dëshmi të mjaftueshme nuk do të thotë se ne kemi dashur ta heshtim të vërtetën për krimet e bëra ndaj popullit shqiptar në Kosovë, por ishte më shumë ndoshta, një dehje me lirinë aq gjatë të pritur. Është koha që me vepra të reja ta fshijmë kohën e humbur. Vetëm ata që dinë t'i çmojnë dhe të mos i harrojnë dhembjet e viktimizeve dhe me dokumente, dëshmi, vepra arti e ndriçojnë periudhën e dhembjeve të kombit, meritojnë të cilësohen të civilizuar.

Nëse institucioneve tona u mungon vullneti për të nxjerrë ligje që personat që kanë përjetuar këto situata të tmerrshme, që ende janë

gjallë e me plagë në shpirt t'iu japin statusin e viktimave të luftës, nëse ato , e kemi për obligim, e këtë mund ta bëjmë, të ngremë padi në gjykatat ndërkombëtare ndërkombëtar për krime lufte, t'i mbledhim faktet për krimet e dokumentuara dhe me to t'i qëllojmë sa kriminelët sa mospërfilljen e atyre që këto krime mundohen mos t' i shohin.

Le të jetë ky libër edhe një shtytje e fuqishme për t'u aprovuar sa më shpejt në Ligjin për statutin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteraneve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe viktimave civile dhe familjeve të tyre” edhe amendamenti ku kërkohet njohja ligjore e grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë.

Pas çlirimit të Kosovës, më duhet prapë mendimi i Kadaresë ku thotë: “ Një omerta”e palejueshme, ka lënë nën perden e mjegullës krimet e lemerishme serbe. Kanë heshtur për të pikërisht ata, që kishin për detyrë ta ngrinin zërin gjer në kupë të qiellit: kronistë, akademikë, historianë, politikanë e publicistë nga të dy anët e kufirit. Opinioni publik evropian e ai botëror, pikërisht, ai që i kishte nxjerr qeveritë dhe ushtritë e vendeve të tyre të ngrinin avionët për të bombarduar Serbinë, pas mbarimit të luftës e pritën me pasurinë dëshminë shqiptare. Ajo dëshmi vononte dhe kjo ishte me të vërtetë dramatike. Nuk ishte thjesht një vonesë. Ishte më shumë se kaq”. Libri i Naxhije Doçit që po e promovojmë sot në anglisht është një veprim shumë i qëlluar në zbardhjen e të vërtetave për këto vepra makabre të ushtrisë pushtuese serbe që duke e shkelur dinjitetin e gruas, dinjitetin e kombit, dëshën ta ngjallin mesjetën në fund të shekullit XX.

BASHKËBISEDIM NDËRMJET RENATE SOLBACH ME JUDITH BUTLER

Feminizmi nuk duhet të dorëzohet përballë instrumentalizimit

Solbach: Logjika demografike parashikon një rënie të popullsisë në shoqëritë perëndimore si dhe të atyre 'të infektuara' nga Perëndimi. Në disa shoqëri, ky paraqet një zhvillim kërcënues. Rusia është shembulli i fundit: Putin ka njoftuar për hapa drastikë për të shtuar normën e lindjeve. Gjermania sapo ka paraqitur një projektligj për të ndihmuar nënat e reja, ndërsa fondet tjera për të janë anuluar. Konteksti është se e 'njëjta gjë vlen për çdo rast': shifrat e popullsisë paraqesin burimet e mbi-jetesës dhe pushtetit, dhe pasi që ka dyshime se pakica emigrante do të bëhet shumica interesi i të cilëve për t'u bërë qytetarë (citoyens) të cilët e përfaqojnë frymën e institucioneve publike (Esprit des Lois) dhe që kanë interes në shpërhapjen e tyre, imigracioni nuk shihet më si alternativë e kapshme karshi shumimit të popullatës vendase. Duke pasur parasysh zhvillimet e tilla të mëdha, a thua është fare e mundshme me pasë politika specifike për gratë? Nëse edhe ka, a ka gjasa që të jenë vetëm 'kozmetike'? Çfarë mendimi keni për të ashtuquajturat politika të lindjes për gratë, si të veçanta nga praktika e vetmistifikimit të nënës promovuar nga trupi ligjor, diçka që dikur i zihet të madhe Julia Kristevës?

Butler: Mendoj se kjo që po e ngrini është shumë e rëndësishme. Por le të marrim parasysh faktin se praktika e krijimit të avantazhit demografik të një kombi të caktuar është praktikë e mocme. Është më ajo praktikë që Hannah Arendt e ka kritikuar fuqishëm në esenë e saj Rënia e shtetit-komb dhe fundi i të drejtave të njeriut.*

Kisha me qenë për një feminizëm Arendtian, po të mund ta kishim një të tillë, në lidhje me këtë çështje. Kjo për shkak se qëllimi nuk është që të mistifikohen gratë si nëna, por që të kuptohet mirëfilli se në riprodhim bëhen investime politike për shkak se nëpërmjet riprodhimit riprodhohen (ose jo) raca e kombi. Natyrisht, shteti i Izraelit ka një politikë të qartë lidhur me avantazhin demografik të hebrenjve, dhe edhe pse një parim

kësisoj shkon ndesh me nocionet demokratike të barazisë, shumica e marrin për të mirëqenë, sepse riprodhoni popullin hebre. Sikur hebrenjtë të mos i nënshtrueshin shfarosjes masive nën nacional-socializmin, ky argument nuk do të kishte ndonjë përdorim brenda politikës bashkëkohore. Por ndoshta nuk do të mund ta kuptonim fare politikën bashkëkohore jashtë kësaj të kaluarë. Mua më duket se në Bashkimin Evropian, si dhe në Britaninë e Madhe, shqetësimet rreth martesave të përziera vijnë nga ata që duan të mbështesin pastërtinë kombëtare dhe kulturore dhe kjo mund të kuptohet vetëm si racizëm. Si rezultat, duhet me qenë të kujdesshëm kur vende të tilla papritmas ofrojnë përfitime për gratë që riprodhojnë ose, si në Izrael, kur shteti për çudinë e të gjithëve, shfaq tolerancë për homoseksualitet dhe lezbiket, që bëjnë riprodhimin e familjeve hebraike në çfarëdo mënyre të mundshme. 'Liritë' tona në njëfarë mënyrë dalin prej projekteve të tilla raciste, kështu që çështja e luftimit për të drejtat riprodhuese bëhet e rëndësishme, lufta për qasje më të mirë në teknologjinë e riprodhimit, ligj birësimi të liberalizuar, kujdes shëndetësor, asistencë shtetërore për fëmijë, por edhe të luftimit me ato regjime të biopushtetit që kërkojnë të krijojnë përparësi demografike të racës dominuese. Pasojë e gjithë kësaj është se nuk mund të ketë politikë radikale seksuale që nuk e kundërshton racizmin.

Solbach: Është thënë se teoria feministe është e pavëmendshme ndaj fëmijëve. Ndoshta ky është keqkuptim apo paragjykim. Por në një shoqëri si jona, gra të shquara, pa fëmijë, të reja, të arsimuara mirë, që prej çerdhës janë rritur nga gra feministe, në pozita akademike - në fakt e 'thonë' marrëdhënien mes gjinive duke i pasur parasysh interesat e fëmijëve. Ka një degë të re të psikologjisë që merret me eksperimentet gjinore dhe me konstelacionet me vetëm një fëmijë. Stabiliteti i roleve gjinore, tani është e qartë, është më pak i rëndësishëm

për të rriturit sesa për rritjen e duhur të fëmijëve. A është e mundur që një teori e cila i kushtoi vëmendjen humlumentit dhe luftimit të mekanizmave të represionit midis gjinive të ketë prerë padashur lidhjen me fëmijët? Por me siguri fëmijët nuk janë armiku? Çka tregon kjo për këtë teori?

Butler: Mendoj se ka disa teori që në mënyrë eksplicite i kundërvihen 'fëmijës' si një problemi ideologjik, por në masën më të madhe, më duket mua, të menduarit për marrëveshje të reja farefisnore, të familjeve të përziera, të formave të reja të komunitetit dhe miqësisë jashtë martesës janë pothuajse qendrore për feminizmin dhe teorinë seksuale progresive. Ma merr mendja se çështja e nevojave të fëmijës është bërë kryesorja në debatet për prindërit e homove dhe lezbikeve. Ka disa teori psikologjike që ruajnë një vend mjaft të madh për 'babën', që kuptohet si empirikisht ashtu dhe simbolikisht, për riprodhimin si të mashkullsisë ashtu edhe të kulturës për fëmijën djalë. Këto teori gjithashtu ndonjëherë insistojnë në primatin e nënës biologjike si parakusht për akulturimin. Por unë mendoj se këto janë pozita teologjike të maskuara si teori psikologjike dhe ata e shohin bërthamën heteroseksuale si strukturën e vetme të mundshme shoqërore që do të mbajë të paprekur orientimin dhe zhvillimin e fëmijës. Mendoj se duhet t'i përdorim studimet në antropologjinë dhe sociologjinë që merren në fakt me atë se si fëmija e negociacion homoseksualizmin, lezbianizmin, dimensionin çorod-gjinor (genderqueer) të jetës e botës të prindit të vet. Këto nuk janë as për së afërmi aq traumaticë sikur mendohet që janë, kështu që duhet të pyesim se pse diçka që paramendohet bëhet diçka e fiksuar, e frikshme dhe fobike. Çfarë strukturash sociale mban në këmb një fobi e tillë? Dhe cilat këqyrë t'i përjashtojë? Kur maskohet si teori, ajo merr tonin e një fakti shkencor paternalist, që duhet të përulet me anë



Judith Butler

të përqeshjes, me anë të zemërimit si dhe me anë të lëvizjeve opozitare të të gjitha llojeve.

Solbach: Përderisa projekti feminist ka ngecur, gatishmëria për të përdorur gratë si armë rritet në të dy anët e përplasjes të qytetërimeve të Huntingtonit. Kjo duket shumë qartë gjatë fushatës afgane, kur përkohësisht u dha përshlyerja se ushtria e SHBA-së po lufton për të drejtën e grave afgane që të mbathin xhinse dhe të kenë vende pune. Që atëherë, çështjet e tilla janë shukatë për arsye që i dinë të gjithë. Nga ana tjetër, mediet tona zbuluan se familjet tradicionale, kryesisht ato të imigrantëve turq, janë bastioni i persekutimit të femrave, duke implikuar kështu se ky duhet të tejkalohet në mënyrë që turqit më të rinj të mund të integrohen në normat shoqërore gjermane. Një qasje e tillë e shpërndall faktin që familjet e tilla (gra e burra) kanë një reagim mbrojtës ndaj normave të tilla, kryesisht perëndimore. Në shumë raste, zgjedhja provokuuese e veshjes që gratë muslimane veshin në publik mund të kuptohet si provokim i qëllimshëm. Ndryshueshmëria kulturore dhe shtypja e grave në këtë mënyrë bëhen sinonime në të dy anët. A duhet të dorëzohet feminizmi karshi tendencave që të përdoret në këtë mënyrë?

Butler: Unë jam mjaft e sigurt se feminizmi nuk duhet të dorëzohet karshi instrumentalizimit të tillë. Keni të drejtë që ta përshkruani si të tillë, por ka shumë mënyra për t'u marrë me këtë çështje. Unë mendoj se pika e parë do të ishte të bashkoheshim me lëvizjet e grave në Afganistan për të parë se me çfarë termesh e artikulojnë ato përpjekjen e tyre. Kundërshtimi i torturës dhe përdhunimit duket vendimtar në këtë drejtim, por këtu duhet të marrim parasysh ndjeshmërinë e grave të sapoçliruara afgane ndaj dhunës edhe nga SHBA-ja. 'Heqja e vellos' të grave afgane në faqet e New York Times-it kur Shtetet e Bashkuara hyn në atë vend u vu përballë një imazhi të burrave të lëshuar papritmas në një grumbull të izmuarëve pornografike. Kjo ngriti çështjen nëse vetë Times-i merret me pornografi ose e përkrah atë. Këtu nuk dua të futem në debat për pornografinë, por vetëm dua të pyes a thua 'liria' që SHBA-ja mbrojnë në sipërmarrjet e tyre ushtarake nuk i bën gratë më të disponueshme si mall për përdorim seksual sesa e kundërta. Në këtë kuptim, kjo nuk ka të bëjë me lirinë seksuale të grave aq sa me atë të meshkujve, dhe me një nocion të caktuar mashkullor të grabitjes, që është shumë i lidhur me pushtimet ushtarake dhe me pohimet e nacionalizmit.

Mendoj se kur mediat fokusohen në nënshtrimin e grave brenda komuniteteve të emigrantëve turq, ato shpesh përpigjen ta shpallin statusin 'superior' dhe 'më të ngritur' të kulturës gjermane. Por ato gjithashtu autorizojnë politikën e veta paternaliste, përfshirë edhe mjetet e integritetit me dhunë. Mendoj se 'integrimi' si model duhet të kundërshtohet. Ai i përket një kornize ku ka ose separatizëm ose integrim. Dhe të dyja këto opsione nuk shohin se dallimet kulturore, heterogjeniteti kulturor, janë pikërisht ajo që tani është gjermane

D. D.



Renate Solbach

dhe sigurisht ajo që është veç evropiane. Ai paraqet edhe idealin gjerman edhe atë evropian si ideale nostalgjike dhe racore, ideale të cilave emigrantët e rinj janë të detyruar t'u nënshtrohen. Pra, feminizmi, edhe një herë, duhet të kujdeset jo vetëm për statusin e grave por edhe që t'u kundërvihet formave të pastërtisë dhe të superioritetit nacional dhe racor. Nuk mund të ketë feminizëm në situatën bashkëkohore botërore e që të mos i kundërvihet në mënyrë aktive llojeve të dhunës nacionaliste që përshkruajnë politikën e emigracionit në Evropën e sotme.

Solbach: Një pyetje lidhur me një person si Bin Laden-i: Pse asnjë femër karizmatike, 'udhëheqëse' e këtij lloji, po aq elokuate dhe këmbëngulëse si ky njeri irritues më konotacione ambivalente nuk përballat me të për të tejkaluar lojën çnerëzore dhe shkatërruese që po e bëjnë mes vete udhëheqësit e luftës islamike dhe kundërshtarët e tyre perëndimorë? Ndoshta një pyetje e tillë duket ose naive ose cinike, por një herë për njëherë përfutuesit e luftës janë duke e udhëheqë diskursin për shfrytëzimin e grave nga ana e armikut në të dyja anët. Sa janë asimetrike lojërat e pushtetit? Në cilën anë nuk përfshihen gratë?

Butler: Mendoj se nuk duhet ta luajmë lojën e liderit karizmatik, pasi nëse dikush udhëheq me karizmën e tij, ai nuk udhëheq për shkak se njerëzit kanë peshuar mendimet e tij ose arsytet për të cilat ai beson. Mendoj se duhet të shkojmë përtej pushtetit karizmatik dhe të mos i harrojmë lidhjet e tij të thella me fazimin. Për këtë arsye, nuk kisha me qenë e lumtur nëse gjendet një grua karizmatike me fuqinë për t'u kundërvënë karizmës së Bin Laden-it ose madje edhe Bush-it/Blair-it. Mendoj se pushteti politik i grave është në organizata e kolektive dhe se sa më shumë që mund ta lidhim feminizmin me politikën antiracistë dhe politikën që kërkojnë fuqizimin e komuniteteve të reja të imigrantëve, aq më mirë do të jemi. Duhet po ashtu të ketë grupe të grave të cilat luftojnë dhunimin dhe përdorimin e forcës, por këto duhet të formulohen pikëpamjet e tyre brenda parame-trave bashkëkohore të biofuqisë. Kjo është arsyeja pse feminizmi duhet të jetë i përfshirë në mobilizime kundër luftës, në politikën demografike si dhe politikën e riprodhimit. Kjo do të jetë një çështje e kapërcimit të rrjeteve famullitare për t'i arritur ato globale të shpërndarjes së analizave tona përmes shteteve, në mënyrë që të ftojme në numër të njerëzve dhe që t'i paraqesim pozicionet tona gjerësisht në dritën e organizimit bashkëkohor të pushtetit dhe dhunës. Nuk mund t'i lejojmë vetes të jemi të ngushtë, identitarianë ose kulturalistë në një moment të tillë.

* Hannah Arendt, Rënia e shtetit-komb dhe fundi i të drejtave të njeriut, shih: kapitullin 5 të Imperializmit.

Çmimi Oscar për femrën prostitutë e mashkullin lider

E diela që shkoi për rreth tri orë i mbajti miliona shikues të ngjitur për televizori. Ata patën mjaft arsye, meqë ky transmetim u konsiderua si më i vlerësuar pas finaleve të "Friends" në historinë e argëtimit në televizion. Prezantuesja e sivjetmë Ellen DeGeneres sigurisht që solli veçantinë e saj e të bërit humor. Ajo zbriti në tokë yjet e Hollywoodit duke u shërbyer pizza siç tha ajo "femrave që s'kishin ngrënë" me javë për të pasur bark të sheshtë" e duke bërë 'selfie-n' e popullarizuar që nisi nga masat për të bërë më pas nga yjet në këtë natë. Nata e çmimeve Oscar është finalja e sezonit të çmimeve në botën e artit. Edhe simpatikja Jennifer Lawrence ishte e pranishme, dhe u rrëzua përsëri.

Por gjatë kësaj jave u vërtetua edhe një herë se titujt më të lartë vjetor të industrisë së filmit nuk njohin kontributin dhe rolin e femrës. Vetëm tre filma me femra në rolet kryesore u nominuan për Fotografinë më të Mirë dhe asnjë nga këta filma nuk u drejtuan nga femra. As kësaj radhe nuk pati femra të nominuara për kategorinë e Regjisë më të Mirë. Nuk ka vend për shumë dyshim kur kujtojmë që shumica dominuese e Jurisë së Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Filmit janë burra të bardhë.

Në një artikull të Newsweek, Amelia Showalter përpigjet të

kuantifikojë 'problemin grua' të Oscarit. Ajo provon të përcaktojë se cilat filma me 'Fotografinë më të Mirë' janë më të vlefshëm - tregimet e grave apo të burrave? Që të përcaktojë se cilët filma ka të ngjarë që janë koncentruar në një gjini, Showalter u fokusua në nominimet për 'Fotografinë më të mirë' ku vetëm aktorë apo aktore u nominuan për kategorinë e aktorit kryesor apo dytësor.

"Po qese Oscarit nuk do të kishte paragjyqime gjinore, do të prisnim statistika të ngjashme për këto dy ekstreme të spektrit", shkruan Showalter. Por çka ajo erdhi në përfundim është që:

Vetëm 38 filma të nominuar për Fotografinë më të Mirë kishin nominime për kategorinë e aktoreve dhe s'kishin nominime për kategorinë e aktorit.

Përkundër kësaj, ka pasur 146 nominime për 'Fotografinë më të mirë' me nominime për aktorë dhe asnjë nominim për aktore.

Nga 83 filma që kanë femrën në qendër, vetëm gjashtë kanë fituar 'Fotografinë më të Mirë' - më pak se gjashtë për qind.

Filmat ku mashkulli është në qendër kanë më shumë mundësi për të marrë statujën e artë në 29/146 apo 20 për qind.

Showalter vëren se dallimet janë edhe më të mëdha për filmat që kanë më shumë aktorë apo aktore të nominuar. "Sa më shumë aktorë, aq më i mirë është

filmi, apo jo? Po, nëse këta aktorë janë meshkuj. Nga të gjitha nominimet për filmin më të mirë me më shumë se një aktorë të nominuar (por asnjë aktore), 44 për qind fitojnë çmimin e madh. Vetëm 7 për qind e të nominuarve për filmin më të mirë me më shumë se një aktore të nominuar (pa aktorë meshkuj) kanë fituar. Kjo është më keq se 9 për qindësi i filmave që s'kanë pasur nominime për aktorin/en më të mirë."

Edhe Huffington Post ka bërë një shkrim për rolet e meshkujve dhe femrave të cilat fitojnë statujën e artë.

"Nëse je mashkull, luajje një figurë historike sikur fituesi i vitit të kaluar Daniel Day-Lewis në Lincoln. Nëse je një grua që synon trofeun, luajje nënën, gruan, të dashurën apo vajzën, pra të kundërtën e një lideri mashkull. A marrin trofe meshkujt që luajnë të dashurin apo burrin? Jo. As që nominohen madje. Ata kanë role të gjykatësit apo ushtarit dhe të 'arritjes në karrierë", sipas Huffington Post. Përveç të qenit grua, nënë, e dashur apo vajzë, gratë fitojnë Oscarin duke luajtur prostitutën, dashnoren, amvisen apo shërbyesën.

Duhet të ketë një arsye pse trofeja e lakmuar është një statujë burri...



TSHI RZIRI

Ky botim është përkrahur financiarisht nga:

